

BIBLIOTEKA E PIONIERIT

BIBLIOTEKA E

SHTETTE

GJOKASTER

SPIRO XHAI

KUR NDERTOHEJ HIDROCENTRALI

(Novelë)

BIBLIOTEKA E PIONIERIT

85H - 32

Xh. 23.

85H - 32

S

SPIRO XHAI

R

KUR NDĒRTOHEJ
HIDROCENTRALI

(Novelë)

47475

31640

BIBLIOTEKA E SHTËPISË
NACIONALE

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

I. NË KAMPIN E PUSHIMIT

Mark Misha mbërriti në plazh pasdite vonë.

Zbriti nga maqina tërë qejf, mori valixhen e vogël në dorë dhe u fut në korien e plepave. Më në fund do të prehet e do të shlodhet mirë për pësëmbëdhjetë ditë rrjesht në kampin e pushimit, në atë plazh të bukur, që i zgjon në mendje njëmijë kujtime të së kaluarës.

Koha mbante për bukur. Megjithëse qe fillim tetori, dielli shkëlqente punemadhe.

E vërteta është se ai kishte ndërmend ta merrte lejen në verë. Po ai ishte viti i një pune të jashtëzakonshme, jo vetëm për atë dhe për brigadën e tij, po për gjithë kantierin. Ndërtimi i uzinës së madhe, që kish filluar para tre vjetësh, duhej të merrte fund. Kështuqë vala e punës erdhi duke u shtuar papushim.

Gjatë muajve të verës, dhe veçanërisht gjatë shtatorit, ai s'kishte kohë të merrte frymë, si i thonë fjalës, dhe jo të mendonte për leje e për pushim.

Kthehej me natë në shtëpi e në mëngjez ngrihej pa u hapur dita. Një natë, që u kthye më herët se ditët e tjera, vajza e tij e vogël, Mrika, rendi kur e pa, dhe i tha me një frymë:

— Babi, ku ke qenë ti kaq ditë?

Marku qeshi, e puthi në faqe vogëlushen dhe i foli për punën e madhe që kishin në uzinë...

Por ja që uzina kishte marrë fund dhe provat e para kishin dalë shumë mirë. Tani punëtorët e ndërtimit s'kishin më punë atje: vendin e tyre e kishin zënë ata që dinin të venin në lëvizje maqineritë pér të prodhuar pleh kimik. Kështu që Marku ishte i lirë të nisej pér pushime.

Rrugës, duke udhëtar me autobus, thoshte me vete: «Leja është një gjë e madhe pér punëtorin. Atje, në kamp, do të shlodhem e do të njihem me shokë të rinj. Po të mbajë koha, kështu siç e ka nisur, do të kënaqem shumë.»

Me këto mendime në kokë ecte në mes të plapave, ku binin pjerrtas rrezet e diellit që po perëndonte. Rrugës nuk pyeti njeri se ku ndodhej kampi i pushimit, mbasi e ndjente veten si në shtëpi të vet, se kishte jetuar aty pér një kohë të gjatë. Mirëpo, kur vështroi mirë rrerherrotull, e kuptoi se po ecte në tym. Plazhi nuk ishte më ashtu siç e njihte ai këtu e njëzet e ca vjet më parë. Nga të gjitha anët çdo gjë kishte ndryshuar. Vetëm deti, që shtrihej disa hapa më tutje, kishte mabetur po ai...

Duke kaluar pranë një ndërtese të madhe, që ishte hotel, pyeti një kamarier, i cili rregullonte tryezat në verandë:

— Ku është kampi i pushimit, or shok?

— Kampi i punëtorëve?

— Po.

— Ecë përpara. E shikon atë vilë atje, me një verandë përpara?

— Po.

— Atje është.

Këmbët sikur e çonin vetë. Eh, sa herë kishte ecur zbathur mbi atë rërë të bardhë, që i kërciste nën këpucët e reja! Ju afroa vilës së mesit dhe ndjeu se zemra i rrahu fort. Ja dera e hekurt e oborrit të vilës, që mbahej gjithnjë e myllur. Kurse tani ishte hapur krejt. Ja edhe shkallët me pllaka prej mermeri të bardhë, që i njihte aq mirë.

Po pse i dukej aq e rëndë valixha që mbante në dorë? Përse i dridheshin këmbët duke ngjitur ato shkallë, që dikur i kapërcente dy e nga dy?

Në verandë kishte një grup njerëzish. Edhe në mesore kishte lëvizje të madhe. Shumë veta shkonin e vinin duke biseduar me zë të lartë. Padashur vuri dorën në ballë dhe tha me vete: «Ku gjendem kështu?»

— Tani erdhët, shok? — e pyeti një grua që mbante një vandak çarçafësh në dorë.

— Po, — ju përgjegj ai si i lehtësuar. — Erdha për të kaluar pushimet në kamp.

— Mirë; paraqituni në atë zyrën atje. E keni fletën e kampit?

— Po, e kam, — ju përgjegj ai dhe hyri si i hutuar në zyrë.

Pas pak doli i pasuar nga një burrë i trashë, i cili i thirri gruas që mbante vandakun e çarçafëve:

— Emine, rregulloje shokun në dhomën numër dy!

Emineja ju ngjit shkallëve dhe ai i vajti pas. Po ku hyri ajo? Ai qëndroi te dera.

— Urdhëro, — i tha. — Kjo do të jetë dhoma juaj. Është një dhomë shumë e këndshme. Ka edhe ballkon. Shikoni sa bukur duket deti!

«Ah, moj motër! Unë di jo vetëm që ka ballkon, po edhe sa pllaka janë shtruar», — desh t'i thoshte, po ajo doli nga dhoma pa u ndjerë.

Marku mbeti me valixhen në dorë, duke shikuar rretherrotull muret, tavanin, dyshemenë dhe i bëhej sikur shikonte fytyra njerëzish të njohur.

Befas u dëgjua një tringëllimë, si një zile shkolle, që vinte nga jashtë. Në mesore u ndje menjëherë një lëvizje dhe zëra njerëzish që zbrisnin shkallëve. «Do të ketë vajtur ora për të ngrënë darkë», mendoi Marku dhe futi valixhen nën shtrat. Pastaj doli njëherë në ballkon.

Njerëzit drejtoheshin nga vila tjetër. Siç duket, atje do të ishte mensa. Doli edhe ai nga dhoma me njëmijë mendime në kokë. Drita elektrike ishte shuar, po megjithëse ishte errësirë, ai i zbriti shkallët sikur të ishte në shtëpi të vet.

Kur mbërriti në mensë, qëndroi njëherë te dera dhe hodhi vështrimin nëpër tryezat se mos gjente ndonjë të njohur.

Në një tryezë prapa derës ishte ulur një punëtor i moshuar, që e shikonte me kureshtje. Edhe Marku e shikoi me vëmendje.

— A do të ulesh? — e pyeti punëtori i panjohur.

— Vetëm je? — i tha Marku.

— Po.

— Atëhere po ulem.

— Sonte erdhe? — e pyeti i panjohuri pas një heshtjeje të shkurtër.

— Po, sonte. Kam ndonjë orë.

— Edhe unë mbrëmë erdha... .

Punëtori i panjohur vazhdonte ta shikonte me kureshtje dhe sikur përpiquej të sillte diçka ndërmend.

— A ke punuar ndonjëherë në Kurbnesh? —
e pyeti mbas pak i panjohuri.

— Posi, ore, — ju përgjegj Marku.

— Unë të mbaj pak mend, më duket sikur ke
genë në brigadën e Markut.

— Të cilit Mark?

— Në brigadën e Markut, që merrte përsipër
të punonte në sektorët më të vështirë.

— Në Kurbnesh kudo vështirë ka qenë, —
ju përgjegj Marku dhe u skuq në fytyrë. «Po të
më pyesi se si quhem, do ta hedh fjalën gjetkë,
që të mos e marrë vesh se jam Marku», — tha me
vete, duke shikuar listën e gjellëve.

— Ti, në Kurbnesh je tani? — pyeti Marku.

— Po.

— Me se merresh?

— Jam minator.

Marku e shikoi njëherë dhe ra në mendimë.

— Dukesh si i mérzitur, — tha përsëri i pa-
njohuri.

— Jo, bre!

— Do të jesh lodhur nga rruga.

— Mundet. Kam bërë disa orë rrugë me maqinë.

— Këtu njeriu e merr veten shpejt. Edhe
sëmurë të jesh, bëhesh menjëherë mirë. Jo vetëm
që s'të mungon asgjë, po ke edhe shoqëri të mirë.
Të mrekullueshme. Ke për të parë...

— Të besoj.

— Në ç'dhomë të caktuan për të fjetur?

— Në dhomën e gjumit, — ju përgjegj si
hutuar Marku.

Bashkëfolësi e shikoi si me dyshim, ndërsa me
vete tha: «Eshtë në vete ky? «Në dhomën e gju-
mit», thotë! Sikur ka vetëm një dhomë gjumi
këtu!...»

- Desha të thosha... desha të thosha në atë dhomën e vogël me ballkon, i shpjegoi Marku.
- Ç'numër ka?
- Numër dy më duket. Ashtu tha pastruesja.
- Me ballkon është?
- Po, nga ana e detit.
- Mirë e ke. Dhoma numër dy është. Kurse unë jam në dhomën përbri.
- Qënkemi komshinj.
- Këtu jemi të gjithë si në një shtëpi.
- Po ai tjetëri që fle atje kush është vallë?
- A, po; është një shok që punon në një oficinë në Patos. Maqo e quajnë. Djalë për kokën e djalit.
- Shumë mirë.
- Unë jam në dhomë me një tipograf nga Tirana. As ai nuk më njihte, as unë nuk e kisha parë ndonjëherë. Po brenda një dite e një nate u bëmë miq të ngushtë. Po ç'u bë xhanëm? Pse nuk erdhi të hajë bukë?
- Do të ketë dalë shetitje.
- Nuk besoj. Ai është tifoz i madh shahu. Do të jetë duke luajtur në ndonjë dhomë e ka harruar që ka vajtur ora për të ngrënë.
- Kur mbaruan së ngrëni, takuan në verandë dy punëtorë të tjerë që drejtoheshin nga mensa.
- Ne ju presim lart, në dhomën numër dy,
- u tha minatori.
- U ngjitën në dhomën e Markut dhe dolën në ballkon.
- Këtu është mrekulli, — nisi i pari minatori dhe u ul.
- Marku qëndroi në këmbë. Shikonte parmakët e ballkonit, grilat e derës, muret e lyera në ngjyrë bizele të hapur.

- Po ti pse nuk ulesh? — e pyeti minatori.
- Ulu se je i lodhur nga rruga.
- Nuk e ndjej më lodhjen.
- A luan domino, or shok, si ta thonë emrin?
- ja ndërpreu mendimet minatori.
- Mark.
- E si thua, bëjmë një lojë.
- Nuk di të loz domino.
- Po tavëll?
- As tavlla nuk më pëlqen.
- Nuk di ta luash, apo s'të pëlqen?
- Edhe sikur ta dija, sonte nuk do të më pëlqente të luaja.
- Paska lloj-lloj njerëzish në botë, — tha minatori duke e shikuar me kureshtje.

Në atë çast, në mesore u dëgjuan të qeshura me zë të lartë. Dera u hap me rrëmbim dhe në dhomë hynë tre burra. Dy nga ata Marku dhe minatori i kishin takuar te veranda, kurse i treti ishte i gjatë e i hollë që, po ta shikoje një herë, nuk e harroje kurrë.

— Ky është një shoku im nga stabilimenti i sharrave të Fushë-Arëzës, — tha Maqua.

— Tani të njihesh mirë edhe me shokun tim të dhomës, — shtoi minatori. — Para se të vinte në kamp, e quanin Adem, kurse tani ja kemi ndërruar emrin. Mos u çudit. E di si qëndron puna? Sapo erdhi në kamp, bëri një shaka me ata të kuzhinës që t'u merrete dy pjata me gjellë dhe ne i ngjitëm menjëherë njënofkë, që shpresojmë se do t'i mbetet për gjithnjë. E quajtëm «llupës».

Dy burrat e tjerë qeshiën me të madhe, kurse minatori vazhdoi: — Ehu, sa qyfyre ka ky!

— Dhe të kesh mendjen, — tha burri i gjatë, — se ta hedh kur të duash.

— Faleminderit, — tha ai që e quanin «llupës», duke përkulur trupin me dorën në zemër.

Marku u zgjati dorën të tre burrave pa thënë asnjë fjalë. Maqos, me të cilin do të banonte një dhomë, i hodhi një vështrim hetonjës. Ai ishte një burrë rrëth të dyzetepe save, me trup të shëndoshë e me fytyrë të celur prej babaxhani.

Pak më vonë, kur e pyeti se sa kohë kishte që punonte në oficinën e riparimeve të maqinerive të rënda në Patos, Maqua ju përgjegj me të qeshur:

— As unë s'e mbaj mend mirë, që kur isha djalë i ri, nja katërmëdhjetë — pesëmbëdhjetë vjeç. Ndaj më thonë tani shokët se, sado që të lahem e të pastrohem, trupi im lëshon një erë vaj lubrifikant e benzinë.

— Si duket, në vend të gjakut, ke në deje vaj e benzinë, — tha me një seriozitet të shtirur «llupsi».

U ulën në karrige. Vetëm Marku qëndronte në këmbë.

— Aa! Ti je mysafir sonte e duhet të ulesh i pari, — i tha burri i gjatë, duke u ngritur nga karrigia, për t'i lëshuar vend shokut.

— Faleminderit, nuk ulem, — u përgjegj Marku duke i vajtur pranë.

— Pse?

— Më pëlqen më mirë të rri në këmbë.

— Si të duash...

Mbrëmja qe e butë dhe e ëmbël; mbrëmje vjeshte që të hidhte në ëndërrime. Hëna apo ishte ngritur mbi korien e plepave dhe i jepte detit një bukuri të rrallë. Jashtë kishte qetësi. Vetëm prej së largu dëgjohej një melodi e gjezuar fizarmonike.

Marku rrëshqiti pa u ndjerë dhe hyri brenda një dhomë.

— Si shumë serioz na rri ky shoku i ri,
Maqo, — tha «llupsi».

— Do tē shtrohet edhe ai, mos ki merak, —
ju përgjegj Maqua.

— Ku punon vallë?

— Ka qenë njëherë në Kurbnesh; tanë është
brigadier në një kantier tjetër, nuk e di si ma tha.

— Më duket pak si mendjemadh.

— Jo, ore! Mendjemadh nuk është, po do tē
ketë ndonjë hall.

Pa e zgjatur shumë, minatori thirri me zërin
e tij tē trashë.

— More Mark! Pse rri veças, bre burrë? Dil
në ballkon! Këtu bën fresk.

— E di si them unë? — foli «llupsi» kur e pa
Markun te dera. — Mirë, mua më kanë ngjitur
nofkën «llupsi». E hëngra unë atë, megjithëse nuk
besoj që tē jem vetëm unë «llupës». Por mendoj
se këtu ka vend përnofka tē tjera.

— Përshebull, ja priti i gjati.

— Po ja, ty tē tē ngjitim nofkën «zdap», —
u përgjegj aty për aty «llupsi».

— Shumë mirë; e pranojmë! — e vulosi mina-
tori.

— Po Maqos?

— Maqua e ka «vajlubrifikant».

— Kurse mysafirin e ri, — meqë na rri pa
folur, them ta quajmë «seriozi».

Marku deshte tē kundërshtonte e tē thoshte
se ai nuk e kishte zakon që tē qëndronte larg
shokëve, po ashtu e kishte punën. Po «llupsi» va-
zhdoi:

— Si tē duash. Po s'të pëlqeu «serioz», tē
gjejmë një tjetër; bie fjala «hundëmadhi».

Qeshën të gjithë pa të keq, qeshi edhe Marku dhe vajti pranë shokëve.

— Ulu këtu pranë meje, or mik i ri, — tha Maqua duke i afruar një karrige xunkthi — pa le të thotë «llupsi»

— Mos je me të vërtetë i lodhur dhe do që të flesh? — e pyeti me seriozitet «zdapi».

— Jo, ore! Qysh tani do të flemë? — foli në vend të Markut «llupsi». — Se mos do të shkojmë nesër në ora gjashtë në stabiliment, apo në fabrikë!

— Edhe unë ashtu them, — tha Marku.

— Atëhere përse rri si i mërzitur? — i tha minatori.

— Njeriu ngadonjëherë mërzitet padashur, — tha Maqua. — Niset njeriu për në kampin e pushimit me gëzim të madh, po natën e parë mërzitet, se helbete, ndahet nga fëmija, nga gruaja.

— Jo, more vëllaçko, jo — ja priti Marku.

— Atëhere do të kesh diçka tjetër.

— Epo, kam diçka...

— Po çfarë ke?

— Ja, ashtu, disa kujtime të vjetra...

— Ç'janë këto kujtime? — u habit «zdapi».

— Njeriu kur niset për në kampin e pushimit, i le të gjitha pas: halle, kujtime.

— Ashtu bëra edhe unë, kur u nisa nga shtëpia, po ja që ato më dualën përpara, kur s'e prisja. Është një histori e çuditshme, pak si e vjetër, mund të thuash, po edhe e re.

— Ke ardhur herë të tjera në kamp? — e pyeti Maqua.

— Kam qenë më shumë në kampet malore. Po unë kam qenë këtu para se kjo shtëpi të bëhej një pjesë e kampit të punëtorëve.

— Kur? nuk u përbajt dot «zdapi».
— Para çlirim. Vitin që hyri Italia.
— Ka pasur edhe atëhere kampe? — belbëzoi
si me dyshim «llupsi»

— Ama dhe ti q'na the! — ja priti minatori.
— C'kamp, or djalë? Unë këtu kam punuar
si shërbëtor.

— Shërbëtor?

— S'të besohet? Ke të drejtë ti, se je i ri dhe
nuk i di mirë hallet tonë. Po ja që unë kam punuar
si shërbëtor, pa mbushur mirë të dymbëdhjetat.

— Te cili?

— Te një pasanik, te i zoti i kësaj binaje, që
as emrin nuk dua t'ja dëgjoj. Ai kish qenë tregëtar
lëkurash, po edhe lëkurën e njerëzve e rripte pa
mëshirë.

Marku qëndroi për një çast, sikur kërkonte të
kujtonte diçka.

— Epo ... — bëri «llupsi».

— Ja, kështu. Dhe tani, pas njëzet e kusur
vjetësh, kthehem përsëri këtu, që të kaloj pushimet
në vilën e zotërisë së dikurshëm.

— Vërtet, ore! — thirri «zdapi». — Sa shumë
ka ndryshuar kjo botë!

Për një çast në ballkon sundoi një qetësi e
plotë. Dëgjohej vetëm zhurma e dallgëve që bëhej
gjithnjë më e fortë, çka tregonte se koha do të
prishej.

— E shikon, o Mark, si erdhi koha? — ngriti
zërin «zdapi». — Sot shërbëtori fle në vilën e
zotërisë!

— Kësaj i thonë përbysje, — tha Maqua.

— Më mirë thuaj revolucion, — e ndreqi
«zdapi».

Ishte bërë vonë. Nga deti frynte një erë e lagësht vjeshte. Hëna ishte mbuluar me avuj të dendur, që vinin nga perëndimi dhe që përhapëshin në të gjitha drejtimet. Në kamp sundonte një qetësi e plotë. Atëhere burrat u ngritën dhe vajtën në dhomat e tyre. Por gjumi nuk i zuri përnjëherësh.

Më vonë nga të gjithë fjeti Marku.

U përpëlit për një kohë të gjatë në shtrat. Kujtimet e fëminisë së tij të hidhur nuk e linin të qetë. Do të ishte shumë vonë kur e kapiti gjumi. Befas ju duk sikur u hap dera e dhomës me rrapëllimë dhe një zë i egër i bërtiti: «Si guxove ti, o krimb i dheut, të hysh këtu brenda?»

Hapi menjëherë sytë dhe tha duke buzëqeshur: «Janë hijet e së kaluarës, që s'kanë më asnë fuqi».

Gjumi ju largua përsëri. Shumë hollësira të tjera i dilnin përpara syve dhe aq të gjalla, sikur t'i kishin ndodhur dje. Herë-herë i vinte të ngrihej nga shtrati, t'i binte me furi çangës në mes të natës dhe, kur të mblidheshin kampistët, t'u thoshte me zë të lartë... «Dëgjoni, or shokë!...»

II. JETA NË PRANGA

Behari i vogël ka një të keqe; ai nuk zgjat shumë. Kampistët, që një natë më parë kishin fjetur herët, nuk i kishin vënë re shenjat e prishjes së motit. Po edhe ata që kishin qëndruar gjer vonë në ballkon, duke dëgjuar me vemendje kallzimin e Markut, nuk i kishin dhënë rëndësi as zhaurimës së dallgëve të detit, as avujve të dendur që kishin veshur hënën. Kështu që u habitën të gjithë,

kur, ndaj tē gdhirë, dëgjuan se jashtë binte shi i rrëmbyer e me erë tē fortë, që vinte nga ana e detit.

Marku, që kishte fjetur shumë vonë, nuk e kishte ndjerë fare shiun. Po, kur hapi sytë, dëgjoi një zë nga shkallët që thoshte:

— Adem, sot éshtë ditë pér përralla.

— Po, sot do tē dëgjojmë një përrallë tē vërtetë.

Marku buzëqeshi plot kuptim dhe u ngrit. U pre-gatit shpejt e shpejt dhe vajti pér tē ngrënë mën-gjez. Kur hyri në mensë, pjesa më e madhe e shikonin me kërshëri dhe disa sikur bisedonin pér tē me zë tē ulët. Po më shumë u habit kur u kthye në dhomë dhe përveç shokëve tē njojur, pa edhe fytyra tē panjohura. Midis tyre dalloi dy vajza tē reja.

— Dy shoqet e mia, — i tha Ademi, duke i njojur. — Punojmë së bashku në një stabiliment.

— Ne jemi tipografe, — tha njëra nga ato.

— Dhe na pëlqejnë shumë librat. Po më shumë na pëlqejnë ngjarjet që u kanë ndodhur njerëzve tē gjallë dhe kur i dëgjojmë nga goja e tyre.

— A nuk luani më mirë domino? — u tha Marku duke zënë një vend në fund tē shtratit.

— Kemi kohë pér tē luajtur domino, — tha Maqua.

— Po tani ç'bëhet zotëria? — pyeti befas Ademi.

Marku e shkoi një herë me habi, sikur desh t'i thoshte: «E pse ma kujton?»

— Po ti, o Adem, na çove përnjëheresh në

fund, — i tha me shaka minatori. — Prit, bre
djalë, t'i marrim me radhë punët. Hajde Mark, u
drejtua nga ai. — Fillo tani.

— Nga t'ja nisim, — tha Marku i menduar.

— Ja, na thuaj si e qysh u bëre shërbëtor, —
i tha Ademi.

— Ashtu qe koha atëhere, or djalë. Ka pasur
zotërinj e shërbëtore. U bëra shërbëtor nga halli,
nga nevoja. Kisha nja dy muaj që bridhnja rru-
gëve të qytetit për një copë bukë e s'gjeja punë
kurkund. Asokohe ende s'kisha mbushur njëmbë-
dhjetë vjeç. E kush më merrte mua në punë? Lere
pastaj që kam qenë i dobët dhe i rreckosur.

— Po prindët e tu ku ishin? — e ndërpreu
një nga vajzat tipografe, që vinte më e shkurtër
nga shoqja e saj, që quhej Sanie.

— Tjetër histori kjo, — vijoi Marku. — Në-
nën po, e kam pasur. Por babanë edhe s'e mbaj
mend. Pse, do të thoni ju. Se ai vdiq kur s'kisha
mbushur ende shtatë vjeç; dhe nuk vdiq në shtëpi,
po andej nga fshatrat e jugut, ku hapte hendeqe
nëpër çifliqet e agallarëve. Po, edhe para se të
vdiste, se mos rrinte në shtëpi. Ç'të bënte në ma-
lësi, ku s'kishim as tokë, as bagëti? Po ka qenë
edhe një shkak tjetër, që nuk rrinte dot pranë fa-
miljes. Shtëpia jonë ka pasur hasmëri me një fa-
milje në fshat. Kështuqë, ose do të rrinte i mbyllur
brenda në konak, si i burgosur, ose do të degdisej
sa më larg të ishte e mundur.

— Tjetër mesele kjo! tha «zdapi» i habitur.

— Një mesele që ka të bëjë shumë me përfundimin e kësaj historie.

— Vërtet?

— Posi. Kur tē vijē radha, do t'jua them. E qē thoni ju, or miqtē e mi, kur na erdhi mandata se babai i kishte mbyllur sytē përgjithmonë nē një ahur tē botës, nëna vuri kujën. Po ajo, pasi kaloi tronditja e parë, si një klloçkë e mirë, na mblodhi nē krahët e saj e na ngrohu. Me bukë tē thatë, qē i thonë fjalës, po na mbajti tē gjallë. Kaluan katër-pesë vjet dhe unë, si më i madh dhe si djalë qē isha, duhej ta nxirrja vetë bukën e gojës. Kështu, bashkë me një vërsnik nga fshati, zbritëm nē qytet. Në malësi, kur na mungonte buka u futeshim lakrave dhe goricave. Po nē qytet e provova se g'ishte uria. Ndodhte qē tē mos haja fare bukë ditë me radhë. Atëhere më këputeshin këmbët e më dridheshin gjunjët. Kështu qē shtrën-gohesha tē bëja çdo punë; prisja nē axhensi tē autobuzëve tē merrja valixhet e udhëtarëve, bluaja kafe nē një lokal tē madh pranë skelës, piqja gështenja nē një mangall tē vjetër. Vetëm një gjë nuk kam bërë: nuk e kam zgjatur kurrë dorën pér tē kërkuar lëmoshë.

për të kërkuar lemoshë. Shumë herë prisja jashtë një magazine të madhe se mos vinte ndonjë kamion me lëkurë për t'u shkarkuar. Atje vinin maqina që sillnin lëkurë të çdo lloji e nga të gjitha viset e Shqipërisë. Pastaj, kur vinte vapori, i ngarkonin përsëri dhe i çonin në skelë. Në kësi rastesh magazinieri i asaj magazine më merrte edhe mua për të punuar në ngarkimin e kamionave. Unë, si i vogël që isha, hipja lart në stivat për të zbritur dengjet e lëku-rëve. Stivat arrinin gjer në tavan, kështu që s'mund të kacavirej çdo njeri gjer atje lart. Punoja gjithë ditën, ment mbytesha nga era e naftalinës e nga pluhuri i magazinës; dhe a e dini ç'më jepnin në

mbrëmje? Një gjysëm leku në dorë, sa për të blerë një copë bukë.

Kur mbaroja punën dhe dilja nga magazina. më digjte trupi nga naftalina. Me mendjen time thosha se nuk do të shkoja më për të punuar në atë vend të mallkuar, mirëpo pas dy-tri ditësh, u ngjitesha përsëri stivave të lëkurëve. Ç'të bëja? Kur ke uri, nuk ke rrugë të tretë për të zgjidhur në jetë...

Një ditë erdhi në magazinë zotëria. Mbaj mend se ne ngarkonim me ngutje në kamiona lëkurë për në skelë dhe ai qëndroi tri-katër orë. Magazina e mbushur u boshatis. Një vapor i huaj priste të ngarkohej në skelë. Zotëria do të shkonte veçë pas disa ditësh me aeroplan në Itali, që t'i shiste.

Kur u nis kamioni i fundit, qe bëre natë. Ishim të lodhur e të rraskapitur, po venim me shpresë se do të na paguanin më mirë se ditët e tjera. Me këtë shpresë kaluam me radhë nga ustai, që të na jepte «hakun», si i thonë fjalës. Nuk e di nga sa u dha të tjerëve, po mbaj mend, sikur të ishte dje, se mua më dha tre çerekë leku. Unë mblodha buzët dhe e shikova me inat. Ai e vuri re këtë e më tha:

- S'mbete i kënaqur?
- Jo! — ju përgjegja me guxim.
- Shiko, krimbi i dheut! — ashtu më thoshte edhe më vonë. — Ka edhe gojë që të flasë! Në vend që të më thotë faleminderit.

Në atë çast ju afrua magazinieri dhé diç i tha në vesh. Unë nuk i dëgjova fjalët, po e kuptova që i foli mirë për mua, sepse ustai nxori nga xhepi edhe një çerek leku.

— Na, — më tha, — ta kesh për nesër në mëngjez.

Më vështroi njëherë nga koka e gjer në këmbë, bisedoi diçka me magazinierin e më pyeti.

— Dëgjo, or çun: këtu nuk është vend për ty. A nuk vjen të punosh në shtëpinë time?

— C'punë do të bëj? — guxova dhe pyeta unë.

— C'punë? Do të të bëjmë princ,— tha me të tallur zotëria, duke u shkelur syrin të tjerëve.

— Punë shtëpie, — tha magazinieri. — Do të fshish dhomat, do të qërosh zarzavatet, do të shkosh në pazar...

Unë një punë të tillë kërkoja prej kohe, po në atë çast isha i zemëruar me tregëtarin që ishte tallur me mua dhe nuk fola.

— Po ju sikur keni pasur një çunak, — i tha magazinieri zotërisë.

— Na iku dje, zuzari. S'e ç'u grind pak me zonjën dhe pasdite na u zhduk. C'të bësh? Ka ardhur një kohë tanë, që edhe foshnjat janë bërë rebelë.

Dhe ustai bëri të dilte. Po, kur arriti te dera, u kthye e më tha:

— Në qoftë se do që të ngopesh me bukë, eja nesër te ne. Shtëpinë ta tregon Qazua — dhe tregoi magazinierin. — Kështu, o Qazo! Interesohu pak, se unë nuk do të jem këtu.

— Siurdhëron! — tha me zë të lartë magazinieri.

Të nesërmen vajta qysh në mëngjez. Dhe që atë ditë fillova nga puna si shërbëtor. Ja pra, or shokë, se si fillon historia ime në këtë shtëpi. E vërteta është se zotëria ka pasur dy shtëpi. Këtë vilë këtu dhe një shtëpi tjetër në qytet. Gjatë verës rrinte këtu, pranë detit, me gjithë familjen. Po

edhe gjatë dimrit vinte shpesh këtu për ahengje, për të luajtur kumar e për maskarallëqe të tjera. Dhe gjithnjë më merrte edhe mua me vete. Sepse, or miq, zotërinjtë s'mund të rronin asnë ditë pa shërbëtorë. Më kuptoni?

Në fillim më paguante sa i donte qejfi. Dy-tre muaj nuk më dha asnë kacidhe. Vetëm që ngesha me bukë. Të gjitha ato që tepronin nga tryeza e tyre, ishin të miat. Pas tre muajve filloj të më jepte njëzet lekë në muaj. Dhe pas një viti ma bëri tridhjetë. Dhe kjo s'është për t'u çuditur. Asokohe ata qenë vetë zot e vetë shkop.

— E di ç'kam menduar unë? — shtoi minatori.
— Mbrëmë sillja ndërmend historinë e Markut. Dhe e krahasoja me timen, e cila, sado që ndryshon shumë nga ajo e Markut, ka shumë gjëra të përbashkëta. Dhe thashë me vete: «Secili nga ne, që vimë këtu në kamp për të pushuar, ka historinë e vet. Sidomos ata që janë pak të kaluar nga mosha, si vërsa jone. Ndaj do të shkoj te drejtori i shtëpisë së pushimit dhe do t'i them: «Shoku drejtor! E di se ke shumë telashe tani në verë. Megjithatë të takon të bësh edhe një gjë të vogël. Të marrësh një defter të madh dhe ta vësh në atë tryezën e mesit në sallon. Në atë defter të gjithë kampistët që vinë këtu, të shkruajnë për vuajtjet e tyre në të kaluarën. Ky defter i madh për dy-tre vjet do të mbushet dhe do të bëhet një libër i trashë, shumë i vlefshëm për të gjithë, e në radhë të parë për punëtorët e rinj, si Ademi ynë...»

— Shumë mirë, shumë mirë! — tha Maqua, që nuk u përmbajt dot.

— Dhe këtij libri, unë propozoj t'i vemë edhe një titull, — shtoi vajza e shkurtër.

— Çfarë titulli, moj Sanie? — e pyeti Ademi.

— «Jeta në pranga», — tha plot gojën vajza.

— Shumë mirë! Shumë mirë! I ke rënë në të. Po ky defter pak nga pak do të bëhet një libër i madh, se në të do të shtohen edhe kapituj të tjerë. Dhe në këta kapituj nuk do të flitet më për vuajtje, po për heroizmat e punëtorëve.

— Me siguri, — tha minatori.

Të gjithë bënë shenjë me kokë, se ishin të një mendimi. Për një çast në dhomë sundoi një heshtje e thellë. Në fillim kallëzimi i Markut u ishte dukur si diçka për të kaluar kohën. Po tani e kuptioni mirë se kjo ishte një histori têrheqëse që të prekte, që të mësonte e të mbushte me urrejtje për ata zotërinj të fëlliqr...

III. — FLUTURIMI I PARE.

— Këshu, bre burra, — vijoi Marku. — Rroga ishte shumë e vogël, po shuplakat dhe shqelmat as që mund të numëroheshin. Më rrihte ustai kur më dërgonte në qytet pse i dukej se unë bridhja rrugëve dhe kthehesha me vonesë. Zonja e madhe më zhdëpte në dru po të gjente ndonjë bëzhilë të vogël në ndonjë kënd të kuzhinës apo të mesores. Lëre pastaj po të thyeja ndonjë pjatë a ndonjë gotë... Ngandonjëherë ngrinte dorën të më godiste edhe zonja e vogël, po të gjente të pafshira kë-pucët e saj lustrafin. Më vonë, kur u fejua zonja e vogël, çoku më doroviste me ndonjë shuplakë të mirë edhe dhëndëri, kur hyja në dhomën e tyre patrokitur në derë...

Lëre pastaj kur bënин ahengje në këto dhoma.

Ato ishin ditët më të vështira, ditët më të zeza për mua. Pse, do të thoni ju. Sa më duhej të qëndroja në këmbë që pa gdhirë mirë e gjer në mesnatë. Dhe të nesërmen, or vëllezër, të nesërmen që tortura më e madhe. Dhomat duhet të laheshin e të pastroheshin mirë e mirë. Merrja kovën me ujë dhe ja filloja punës. Por vinte një çast që këputeshë fare. Atëhere fillonin të sharat dhe të rrahurat e zonjës së madhe. Të më besoni se shumë herë këto dërrasa i kam lарë më shumë me lot, se sa me ujë. Ndaj çdo gjëzim i tyre bëhej helm për mua.

Kështu rrojta këtu për nja katër vjet të mira, gjersa erdhi një ditë që zotëria u largua nga plazhi me tërë familjen, me gjithëse koha e mirë ende s'kishte marrë fund. Dhe e dini pse u largua? Ishte viti që kapitulluan italianët dhe në vend të tyre erdhën gjermanët. Ata muarën për vete shumë vila dhe ranishten e mbushën me mina. Atëhere zotëria, ashtu si bënë edhe pasanikët e tjerë, mori familjen dhe iku. Më la mua në vilë kurse vetë vajti në një fshat këtu pranë, ku kishte çifligun e tij kruashku i ustait, i ati i dhëndërit. Plazhi nuk ishte më vend i sigurtë për ta. Ashtu si të tjerët, edhe ustai im kishte frikë nga bombardimet. Aeroplanët anglezë vinin shpesh për të bombarduar qytetet tona, gjoja për të démtuar gjermanët. Përveç kësaj, ato ditë flitej se do të bëhej një zbarkim nga ana e detit dhe këtu mund të zhvilloheshin luftime. Unë qëndrova në këtë shtëpi ndonjë javë, po një ditë erdhën gjermanët dhe më përzunë. U nevojitej vila. Ç'të bëja? Të kthehesha në fshat? Rrugët ishin të mbyllura. Kudo bëhej luftë. S'dija nga t'ja mbaja. Të nesërmen e ditës që më përzunë

gjermanët vajta te zotëria t'i thosha se ç'kishte ndodhur. Kur më pa, u habit, sepse gjithë ata pasanikë që ishin zhdukur brenda një nate nga plazhi, mendonin se gjendja do të ndryshonte menjëherë dhe ditët e mira do të kthehen shpejt për ta. Kur i kallëzova se ç'kishte ngjarë, zuri të më qortonte, sikur ta kisha unë fajin. Ndaj e mblođha top me veten time të nisësha për në fshat dhe le të bëhej ç'të bëhej. Mirëpo krushku i zotërisë kishte nevojë për një shërbëtor. Ai më mori e më mbajti atje. Ditët e para ndihmoja në punët e shtëpisë, po, pas ndonja dy javësh, më hoqi nga shtëpia e më dërgoi me lopë. Kështu që rashë nga shiu në breshër, që i thonë fjalës... Që thoni ju, or shokë, krushku i zotërisë kish qenë një çifligar i madh; ai ka pasur toka të shumta në fushë, kullota të mëdha në kodrina, pranë detit, dhe një sërë dyqanesh në qytet, që i jepte me qira.

Atje te çifligu i krushkut të zotërisë ishte dhe një plak i mirë — xha Prenkë e quanin — që çifligari e mbante si stallier. Xha Prenka kishte gjezdisur anembanë Shqipërisë, kish punuar në shumë vise, dhe, siç thoshte vetë, «kudo zengjinët të pinë gjakun si shushunja». Disa vjet me radhë kishte punuar në gropat e Rubikut për të nxjerrë mineral bakri dhe më kallëzonte shumë gjëra për jetën e për njerëzit. Shpesh herë kallzimin e tij e mbyllte me këto fjalë: «Do të thuash ti pse ndodhi kështu. Po unë të kam thënë, more bir, edhe herë të tjera; në qytet janë tregëtarët dhe zengjinët e tjerë, kurse në fshat janë çifligarët, që nuk e lënë miletin të shpëtojë nga hallet».

Xha Prenka kryente punët brenda në stallë: pastronte stallën, milte lopët, u shtinte ushqim në

grazhd dhe dy herë në ditë ja çonte çifligarit qum-shtin e freskët në shtëpi.

Nga sa kisha dëgjuar, cifligari më përpara nuk mbante fare bagëti. Pse të kishte telashe? Atij çdo gjë ja sillnin në shtëpi fshatarët: qumështin në mëngjerez, tëlynin e freskët, qingjat në pranverë, puladeti në dimër, pulastrenë në verë e në vjeshtë dhe çdo gjë tjetër që njeriu merr nga toka e nga bagëtia. Po, kur vajta unë atje, ai kishte një kope prej më se tetëdhjetë lopësh e viçash. Pse do të thoni ju? Çifligari u jepte fshatarëve hua me afat e me kamatë. Më kuptioni? Dhe, ashtu si thonë, paraja sjell paranë, po edhe borxhi pjell borxhin: se kamata shtohet përditë më shumë dhe vjen një ditë që ajo bëhet më e madhe se vetë borxhi. Vinte afati i shlyerjes së borxhit dhe fshatari s'kishte asnjë kacidhe në xhep. Atëhere çifligari i merrte atij kaun e par mendës dhe lopën e qumshtit. Ato që kulosja unë ishin lopët e fshatarëve... Po besoj se ato lopë që kulosja unë, do të ishin të fundit. Se kishte arritur thika në kockë, që i thonë fjala, sa s'durohej më. Kështu që fshatarët nuk pranonin më t'i paguanin borxhet. Për këtë gjë flisnin përditë në shtëpinë e çifligarit. Unë u largova andej dhe nuk e di se ç'u bë më vonë. Po e marr me mend se jehona e pushkës partizane dhe fjala e partisë do të kenë arritur shumë shpejt edhe atje. Para se të largohesha nga çifligari më ndodhi diçka që tregonte se kohët kishin ndryshuar. Dhe kjo u bë shkak që unë të braktisja lopët e çifligarit dhe të merrja arratinë. Është një histori e tërë kjo, po unë do t'jua kallëzoj shkurt si ndodhi, sepse ka të bëjë shumë me rrugën që kam ndjekur në jetë.

Xha Prenka më donte e më imbronte shumë.

Meqë s'kishte fëmijë, më donte si djalin e tij. Në rrnim në një ahur të vogël, ngjitur me një depo të madhe, që përdorej për shtallë. Netve të dimrit ndiznin zjarr, theknin bukën e misrit dhe xha Prenka më kallzonte histori të vjetra ngajeta e tij plot vuajtje e halle. Meqë s'gjenim lehtë dru, disa herë përdornim edhe bajgat e thara të lopëve. Mirëpo ato bënin më shumë tym se sa na ngrohnin. Ahuri mbushej me tym sa të zihej fryma. Shumë herë tymi përhapej edhe në shtallë dhe lopët kolliteshin, sikur t'i kish zënë veremi. Në mes të atij tymi të dendur nuk e dalloja mirë fytyrën e xha Prenkës, po dëgjoja vetëm zërin e tij...

Shumë herë kthehesha nga kullotat i lagur quell dhe atëhere xha Prenka bënte çmos që të më thante rrobat.

Një ditë dëgjova atje, në fushë, një si gjëmim të largët dhe të thellë. S'e kuptova nga vinte, po një fshatar që takova në fushë, më tha se partizanët luftonin kundër gjermanëve. Hollësira të tjera as ai nuk dinte. Në mbrëmje, kur u ktheva në konak, xha Prenka më tha: E dëgjove gjëmimin e topave, o bir? «Po, — i thashë. — Po unë dua të marr vesh se ç'janë këta partizanë se në shtëpinë e zotërisë thoshin shumë fjalë të këqia për ta; po unë nuk u kam besuar». — «Shumë mirë ke bérë që nuk u ke besuar», m'u përgjegj aty për aty xha Prenka dhe shtoi me një frymë: «Partizanët janë armiq të zotërinjve dhe të agallarëve. Dhe gjersa janë armiq të agallarëve, duhet të janë patjetër miq të fukarenjve».

Nuk kaluan shumë kohë nga biseda me xha Prenkën, kur më ndodhi diçka e papritur. Ishte një ditë vere e kthjellët dhe e nxéhtë. I kisha lëshuar lopët në një arë të porsakorrur nga gruri

dhe u futa në një proskë të thellë, ku qe një krua me një curril të pakët uji. Ndërsa isha përkulur për të pirë ujë, m'u duk sikur degët e shkureve të dendura zunë të lëviznin ngadalë dhe dëgjova një si pëshpëritje të lehtë. Ngrita menjëherë kokën dhe pashë një njeri që më bënte shenjë me dorë të afrohesha. Pa u menduar shumë, ju afrova dhe ai, me dorën në buzë, më bënte:

— Shshttt!

— Kush je ti? — e pyeta unë menjëherë.

— Ngadalë. Ngadalë, — më foli ai.

— Këtu s'ka njeri, pse ruhesh kaq shumë?

— Po më ndjekin armiqtë, — m'u përgjegj ai aty për aty.

— Kush je ti?

— Unë? Do ta marrësh vesh. Po prit njëherë të shohim se ku jemi.

Atëhere e vështrova më mirë dhe pashë se në mes të gjunjve mbante një automatik. Mirëpo njëren këmbë e kish të zbatbur e të lidhur me një rrip bezeje të bardhë, të skuqur nga gjaku.

— Mos je partizan? — i thashë me një frymë.

— Partizan jam — m'u përgjegj. — Po mos thirr shumë.

— I plagosur je?

— Po, këtu në këmbë dhe pak në kofshë. Ndaj s'mund të eci dot.

Ishte hera e parë që shihja një partizan. Zemra më rrihte fort nga mallëngjimi dhe ishë gati t'i hidhesha në qafë e ta përqafaja. Po, në atë çast, dëgjova përsëri zërin e tij:

— A ka gjermanë këtu?

— Ka poshtë në xhade, atje kanë komandën e tyre.

— Po ballistë?

— Ballistë ka edhe atje në komandë, edhe në fshat.

— Domethënë do të jetë vështirë të më çosh atje?

— Ku?

— Në fshat.

— Po pse kërkon të shkosh në fshat, për të shëruar plagën?

Nuk m'u përgjegj menjëherë se diçka mendonte.

— Si do t'ja bëjmë? — më tha pas pak.

— E di, o partizan, — i thashë unë, — a nuk vjen në ahurin tonë?

— Ku është ahuri?

— Ja këtu afër. Po prit njëherë të shkoj të pyes xha Prenkën, — dhe u mata të nisësha menjëherë.

— Prit, prit, mor djalë. Mos u ngut. Ç'është ky xha Prenka?

— Xha Prenka?

— Dua të them, a është njeri i mirë?

— Si jo, ai më do shumë.

— Po... për partizanët ç'thotë?

— «Ata janë armiq të zotërinjve dhe të agallarëve», thotë.

Partizani buzëqeshi i kënaqur.

— Shiko, more piciruk, — më tha, — mos më marrësh më qafë.

— Hiç mos ki gajle, — ju përgjegja dhe bëra të nisem. Mirëpo, në çastin e fundit, m'u kujtua diçka dhe u ndala.

— A ke ngrënë bukë? — e pyeta partizanin. Dhe, para se të më përgjigjej, i lashë trastën dhe i thashë:

— Na, kam një copë bukë dhe dy-tri qepë të njoma. Ti ha bukë gjersa të kthehem unë, — dhe ja dhashë vrapit.

Xha Prenka më dëgjoi me vemendje dhe më tha:

— Sille ndaj të ngrysur. Po mos kaloni nga rruga. Futuni nëpër arat e pakorrura dhe dilni prapa kodrës. Do t'ju pres te vidhi i madh.

Kështu thamë e kështu bëmë. Partizanin e plagosur e suallëm në konakun tonë dhe e shtruam në dyshekun e xha Prenkës. Plaku ja zgjidhi plagën dhe ja leu me disa melheme, pastaj i bëri një pëershesh të mirë me qumësh. Po q'më ndodhi mua se! Duke u marrë me partizanin e plagosur, kopenë e lopëve e kisha harruar fare. Ato të mallkuara kishin hyrë në grunjrat e pakorrura dhe kishin bërë kërdinë. Ku vajta t'i mblidhja, pojaku i fshatit më dha disa shuplaka të mira dhe disa shqelma vitheve... Kjo s'ishte gjë fare! E keqja më e madhe më ngjau të nesërmen, atëhere kur erdhi në haur qehajai. E kisha dëgjuar edhe nga të tjerët se qehajai ish një egërsirë e vërtetë. Po nuk ishte vetëm kjo. Kisha hallin se mos na hynte në konak dhe na gjente partizanin. Ndaj renda me të katërta drejt fushës. Prapa meje u lëshua edhe xha Prenka, gjoja të më ndiqte. I fundit u sul qehajai. Kur arrita gjer te rruga e fshatit, bëra sikur rashë. Pse te rruga e fshatit do të thoni ju. Se andej mund të kthehej lehtë qehajai pér në fshat, pa kaluar përsëri nga shtalla, ku mund të zbulonte partizanin. Të rrahurit e qehajait nuk tregohet dot me fjalë. Sikur ta kishte zanat të rrahurit maskarai dhe gjithë jetën të mos ishte marrë me asgjë tjetër, veçse me atë punë! Dhe, po të mos ishte

xha Prenka, ndoshta do të më kishte lënë në vend. Xha Prenka më mori në krahë e më çoi në ahur. Ndjeja dhëmbje të forta. Po dhëmbjet sikur i harrroja kur mendoja se partizani ynë kishte shpëtuar. Xha Prenka nuk pushonte asnjë çast. Kishte shumë punë, i shkreti. Tani duhej të shëronte edhe plagët e mia. Përveç kësaj; kishte edhe hallin e lopëve. Unë s'mund të lëvizja nga vendi. Trupin e ndjeja të troshitur nga shkelmat e qehajait. Prandaj për dy-tri ditë lopët i kulloti xha Prenka. Unë qëndroja i shtrirë bashkë me partizanin. Plagët më dhimbin, po më mbante me kurajë partizani. Çngjarje interesante më kallëzoi ai partizan gjatë atyre ditëve që qëndroi aty! Një pasdite më tha: «Dëgjo! Tani do të të mësoj edhe një këngë partizane». Dhe aty, në ahurin e errët, nisi me zë të ulët këngën partizane:

«*Ato maya rripa-rripa
se ç'gjëmojnë.*...»

Ndaj të ngrysur, kur u kthye xha Prenka nga kullota, unë e isha mësuar mirë këngën dhe e këndoja bashkë me partizanin. Xha Prenka u habit kur dëgjoi këngën dhe sakq u duk te dera:

— Ngadalë, bre çuna, — na tha — se këtu afër kalojnë ballistët. Pastaj pojaku me qehajanë kalojnë shpesh këtej.

Kur dëgjova emrin e qehajait, e ula zërin, po nuk pushova së kënduari. Aq shumë më kish pëlqyer kënga, sa që, edhe kur u largua partizani i plagosur, ja mësova edhe xha Prenkës dhe e këndonim të dy së bashku me zë të ulët. Shpesh herë, kur isha duke kullotur lopët nëpër lëndina e kullota, e këndoja edhe vetë. Dhe mendja më

shkonte menjëherë te ai partizani që ma kish mësuar. Nga sa më kujtohet, partizani vinte nga batalioni që vepronë në zonën malore të krahinës dhe shkontakte me mision për në qytet. Mirëpo rrugës u ndesh me një patrullë gjermane dhe u plagos. Duke patur plagët ende të ngrohta, mundi të têrhiqej dhe të fshihej në grunjërat e pakorrura. Natën u zvarrit gjer në kodër dhe u fut në mes të shkureve, atje, pranë kroit, ku e takova. E mbajtëm shtatë ditë të mira, gjersa e mori veten dhe mund të ecte vetë. Ditën e tetë, xha Prenka e përcollë gjer në qytet. Dhe qysh atëhere nuk e kam takuar më asnjëherë. Zemra ma donte gjithnjë ta takoja edhe njëherë atë partizan të plagosur, që e kam dashur si vëlla. Shumë herë kam pyetur për të, po nuk kam marrë vesh asgjë. Bile nuk di mirë si e kish mbiemrin. Mbaj mend vetëm kaq: emrin e kishte Fatmir.

Po mos mendoni se kjo histori mori fund me kaq. Jo, or shokë, ka edhe vazhdim. Dhe një vazhdim shumë të çuditshëm, që nuk ju shkon në mendje kurrë.

Më duket se ju thashë edhe më parë se dhëndëri i zotërisë vinte shpesh në shtëpinë e vjehrit. Atëhere studjonte në Itali për inxhinier, po verës, kur kthehej në Shqipëri, thuajse gjithë kohën e kalonte këtu, në plazh. Më dërgonte oreçast poshtë e lart për gjëra të vogla. Njëherë më dërgonte në qytet për t'i blerë cigare «Luksi», njëherë tjetër për të lajmëruar miqtë e tij se ku do të kalonin mbrëmjen, e kështu me radhë. Edhe ai edhe e bija e zotërisë, peshonin nga ana e lehtë e kandarit, ashtu si themi ne, domethënë ishin firifiu nga mendja.

Atë vit, për shkak të luftës, ai nuk kishte vajtur në Itali për studime. Dhe, meqë s'kishte ç'të bënte, merrte nusen me vete dhe dilte shetitje lëndinave dhe korijeve. Po tani nuk më kishte më në dorë, sepse, apo i shihja prej së largu, vija përparrë kopenë e lopëve dhe largohesha. Një ditë më doli në befasi e më tha: «Do të shkosh gjer në fshat të na marrësh çadrat se koha u vrejt dhe mund të bjerë shi». «Shkoj, — ju përgjegja unë, — po vetëm me një kusht: që të ruash lopët gjersa të kthehem».

Ai kafshoi buzët nga inati dhe më tha me gjysmë zëri: «Po më re në dorë, s'ke shpëtim. Ta dish mirë këtë». Po s'kishte ç'të bënte më shumë dhe u largua. Zemërimin e mbajti brenda. Dhe e mori hakun në rastin më të parë...

Pas ndonjë javë unë i kisha lëshuar lopët në një lëndinë dhe kisha hipur në majë të një shkëmbi për t'i vëzhguar. Bari i thatë ishte njomur nga shirat e para të vjeshtës dhe lopët kullosnin për bukurin. Pasi u lodha duke qëndruar në këmbë, u ula mbi shkëmb dhe ja mora këngës, në fillim me zë të pakët, pastaj gjithnjë më fort.

*«Ato maja rripa-rripa»
se c'gjëmojnë!»*

Befas ndjeva se dikush më kish ardhur pranë. Ngrita pak kokën dhe pashë se ishte ai, i biri i çifligarit. Oh, si më erdhi atë çast! Ta kisha në dorë, do ta rrëzoja nga maja e shkëmbit poshtë në humnerë! Po isha i vogël dhe i pafuqishëm, ndaj qëndrova në vend si i hutuar.

— Ditke edhe këngë të tillë ti? — më tha si me të tallur.

— Po, di.

— Dhe e këndon mirë, — më tha. Pastaj m'u afroa më shumë dhe më pyeti gjoja me të mirë.

— Po ku e ke dëgjuar këtë këngë? Kush ta ka mësuar? S'përgjigje? Unë po të pyes me të mirë. Ka ndonjë të keqe këtu?

E nuhata menjëherë se ku e kishte qëllimin dhe vendosa me veten time që të mos i thosha asnje fjalë. Atëhere më kapi nga dora e më tha me një zë që tregonte se mezi e mbante veten:

— Dëgjo këtu, or djalë, po të duash të hash bukë këtu, në shtëpinë tonë, duhet të më përgjigjesh menjëherë se kush ta ka mësuar këngën. Përndryshe...

E kuptova se e kisha pisk punën. Ai do të më shtrëngonte të tregoja se ku e kisha mësuar këngën. Dhe me të vërtetë, pas pak më bërtiti me të madhe:

— Folë shpejt! Kush ta ka mësuar këngën. Ndryshe të hodha nga shkëmbi poshtë, që të bëhesh copë-copë.

Në atë çast unë mblodha të gjitha forcat e mia dhe, sa të hapësh e të mbylli shytë, zbrita me shpejtësi nga shkëmbi dhe u gjenda poshtë në lëndinë.

— Ku do shkosh? — thirri ai nga shkëmbi.

— Nuk do të kthehesh në mbrëmje në ahur për të ngrënë bukë?

— Naa! — i bëra unë duke i treguar bërrylin.

— Pa dale njëherë?! Kujt i bën ti ashtu? — më bërtiti duke u vërsulur kundër meje.

Po qe tepër vonë. Unë e kisha marrë në çast vendimin e madh dhe renda me të katra.

Nuk u ktheva më në shtëpinë e çifligarit. As-

një forcë në botë nuk mund të më detyronte të kthehesha përsëri atje. As uria.

Mirë ika nga shtëpia e çifligarit, po ku të shkoja? Kjo është një histori tjetër. Me kaq mbaroi përleshja ime e parë me dhëndërin e zotërisë.

— Pse, ka edhe përleshje të dytë?

IV. TAKIM I PAPRITUR

Pasdite dhoma e Markut u mbush përsëri me njerëz.

Jashtë shtrëngata vazhdonte me furi. Deti gjëmonte me të madhe, si një përbindësh i egërsuar. Vetëtimat çanin oreçast qiellin sterrë të zi dhe bubullimat të shurdhonin veshët. Shiu me erë trokiste me forcë në xhamet e mëdha të derës së ballkonit. Degët e plepave përkuleshin gjer afër dritareve, sikur donin edhe ato të dëgjonin historinë e çuditshme të Markut.

Marku qëndronte në këmbë pranë derës së madhe të ballkonit, duke vështruar nga ana e detit të shkumëzuar. «Ja, kështu si sonte ishte edhe atë natë, — i erdhi atë çast në mendje një ngjarje e hidhur që i kish ndodhur në këtë shtëpi. — Në dhomën matanë, ku fle minatori me Adem, ishin mbledhur miqtë e zotërisë dhe luanin letra. Unë merrja nga kuzhina pjatat e mbushura me meze dhe ua çoja në dhomë. Nuk më harrohet çasti kur zonja e madhe më dha një pjatë të mbushur me peshq të porsafërguar. Era e këndshme e peshqve të fërguar më shponte hundët. Zorrët po më gjerryenin nga uria. Dhe unë me pjatancën e madhe në dorë, ecja si i dehur. Shkallët i ngjita

me zor. Te dera e dhomës m'u ngatërruan këmbët dhe rashë përmbyss mbi dysheme. U bë një rrëmujë e madhe. Një cifël e pjatës më kishte çarë pëllëmbën e dorës së djathëtë dhe nga plaga më rridhët gjak. Nga krisma e fortë, zonja e madhe u dha menjëherë te dera. Kur pa pjatancën të thyer, u bë si e xhindosur. «E kisha blerë në Trieste, more tutkun, more i shastisur, — më gérthiti me të madhe. — Dhe ti ma bëre copë e thërrime. Gomar!» Pastaj më rrëmbeu nga dora më nxori jashtë në shi e në erë dhe më tha me ligësi: «Këtu të ngordhësh, si qen!» Po, po, kështu më tha. E mbaj mend fare mirë. I vogli nuk harron lehtë. Më kujtohet se edhe koha ishte si sonte». Ndjeu të rrënqethura në trup dhe u kthyesh nga ana e shokëve.

— Të gjithë ne, që kemi jetuar edhe para çlirimit, — u thoshte minatori atyre që ishin mblehdhur aty, — mund të kallzonim shumë ngjarje të hidhura ngajeta jonë e kaluar. Po të më thoshte njeri që të flisja për jetën time të atëhershme, do t'i përgjigjesha vetëm me tri fjalë: uri, varfëri, papunësi. Kaq. Ndryshe qenka Marku. Ai mbaka mend edhe hollësirat më të vogla.

— Jo, nuk është ashtu, — ndërhyri menjëherë Marku. — Edhe unë, në raste të tjera, përgjigjesha vetëm me dy tri fjalë. Po këtu, në këtë shtëpi, çdo gjë më flet për jetën e së kaluarës.

Dalëngadalë biseda po fillonte përsëri në një mënyrë fare të natyrshme. Kishte ardhur çasti, që kallzimi i Markut, i mbetur në mes, të vazhdonte përsëri.

— Unë kam jetuar këtu ditët më të vështira të jetës sime, — vazhdoi Marku. — Ditë që s'mund

të harrohen kurrë. Ju thashë në mëngjez se si kisha marrë vendimin e madh të largohesha nga shtëpia e çifligarit. Ju e kuptioni edhe vetë se, pas asaj që më kishte ngjarë, unë s'mund të kthehesha përsëri te ata. Mora, pra, rrugën e qytetit: mbaj mend se shkoja me ngutje. Mirëpo rrugës m'u kujtua xha Prenka dhe u ktheva nga shtalla. Nuk mund të largohesha nga çifligu pa u përshëndetur me plakun e mirë. Nuk vajta fare në konak, po e thirra xha Prenkën jashtë, prapa murit të një godine të prishur. Atje ja tregova fill e për pe se ç'më kishte ndodhur. Ai më dëgjoi i pikëlluar, po në fund e mblodhi veten e më tha: «Po të mbetesh pa bukë e pa konak, këtu e ke xha Prenkën. Mund të vish kur të duash, qoftë ditën, qoftë natën. Një copë bukë për të ngrënë dhe një copë rrugoz për të fjetur do ta gjesh këtu te unë. Hajde, udhë të mbarë». Dhe më puthi si baba në faqe e në ballë.

Unë u nisa për në qytet me njëmijë mendime në kokë. Mendoni një djalë të vogël, nja trembë-dhjetë-katërmbëdhjetë vjeç, në mes të katër rrugeve. Bota më dukej e huaj, e ligë, armiqësore. Më dukej sikur të gjithë më shikonin me përcëmim. Në qytet trokita nëpër dyert e magazinave e në dyert e pasanikëve për të kërkuar punë, po ata më shikonin si të habitur sikur donin të më thonin: «Ne nuk dimë ku kemi kokën, kurse ti na kërkon punë!» Dhe me të vërtetë,jeta në qytet ngjante si e vdekur. Rrallë të zinte syri ndonjë të ri. Më tepër kishte pleq e plaka, që bënин shpejt e shpejt pazarin e strukeshin nëpër shtëpi. Në rrugët e qytetit shkonin e vinin patrulla gjermane. Natën kalonin tanke, duke mitraluar në hava. Ja-

shtë qytetit, sulmet e partizanëve kundër gjermanëve bëheshin gjithnjë më të dendura e më të forta. Disa herë luftimet bëheshin në afërsitë e qytetit. Natën dëgjoheshin krismat e pushkëve e të mitralozëve të partizanëve që sulmonin.

Një ditë ndenja pranë derës së jashtme të një hoteli të madh, duke pritur klientët se mos kishin nevojë për ndonjë hamallëk. I pari që doli qe një burrë i gjatë, me një borsalinë në kokë, që mbante në dorë një valixhe të rëndë. Vrapova menjëherë, ja mora valixhen në dorë dhe me gjysmën e lekut që fitova renda për të blerë bukë. Mund të më thoni: «Mirë për të ngrënë, po për të fjetur si bëje?» Hotel për mua ishte një lulishte e qytetit, e braktisur fare nga shkaku i luftës.

Kështu e kalova kohën gjersa erdhën në qytet partizanët. Mbaj mend mirë se atë ditë isha i pangrënë; pcr, nga gjëzimi i madh, nuk më shkonte fare mendja për bukë. Kisha hipur në një pemë të rrugës kryesore dhe vështroja partizanët që kallonin duke kënduar. Mendja më shkonte te ai partizani i plagosur, te Fatmiri: Hapja sytë se mos e shikoja gjëkundi, që t'i hidhesha në qafë, po nuk e pashë. Po, në qoftë se nuk gjeta partizanin që kërkoja, takova shumë partizanë të tjerë dhe u bëra mik me ta. Një nga ata bile, me një automatik në krah, më mori me vete në komandë. Atje më pyeti për shumë gjëra dhe unë ja tregova të gjitha. Kur i kallëzova për takimin me partizanin e plagosur e ç'më kishte ndodhur me të birin e çifligarit për shkak të këngës partizane, ai më shtrëngoi në gji e më tha: «Tani erdhi koha ta këndosh lirisht atë këngë. Dhe jo vetëm atë, po çdo këngë partizane. Ti je ende i vogël dhe

ndoshta nuk e kupton mirë përbysjen e madhe që po ndodh këto ditë në vendin tonë. Po shumë shpejt ke për ta kuptuar. Vetëm një gjë të them: nëse rrugët e jetës qenë të mbyllura për jetimet dhe, në përgjithësi, për djemtë e fukarenje, tanë e tutje ato do të jenë të hapura. Dhe ti do të zgjedhish atë që dëshiron, atë që të përshtatet më mirë. Mos u habit aspak. Kështu ka për të ndodhur».

Fjalët e atij partizani nuk i kuptova mirë atë ditë. Po nuk kaloi shumë kohë dhe m'u dha rasti të bindesha se ishin të vërteta. Atëhere thashë me vete: «Sa të drejtë ka pasur ai partizan që më foli atë natë».

S'do mend se s'mund të rrija për gjithnjë në komandë. Gjatë tri ditëve që qëndrova atje, ata të komandës më gjetën një palë rroba të përdorura, po të mira, e më thanë: «E, Mark, si do të bësh tanë? Do të qëndrosh këtu, apo do të nisesh pér në shtëpi? Sepse ne do të largohemi nga qyteti pér të ndjekur këmbakëmbës armikun». Unë mbeta si në mëdyshje. Më pëlqente të kthehesha në shtëpi, të çmallesha me nënën e me motrat, po më shumë më pëlqente të vazhdoja rrugën me partizanët. I hodha, pra, një shikim atij partizanit të gjatë, që më kishte marrë nga rruga ditën e parë, sikur t'i thosha: «Po ti si thua?» Ai e kuptoi menjëherë domethënjen e shikimit tim dhe më erdhi pranë, më përkëdheli një herë flokët e pakrehur e më tha: «Unë them që të vish me ne.» Të nesërmen u nisa bashkë me partizanët që shkoni mësuan shkrim e këndim dhe kujdeseshin pér mua si pér vëllanë më të vogël të familjes së tyre

të madhe. C'ditë të paharruara qenë ato për mua! Mbas çlirimit shkova në fshat. Sa të gjëzuar që i gjeta! Ngado dëgjoheshin këngë partizane. Unë nuk besoj të kenë kënduar njerëzit më shumë se atë vit. Këndoja dhe unë bashkë me ta. Filloja me atë këngën që më kishte mësuar partizani i plagosur, pastaj i merrja të gjitha me radhë. Shumë herë vija në mal me kalamaj të tjerë për të kullo tur bagëtinë, dhe unë u mësoja këngët partizane **dhe i këndonim të gjithë së bashku, në kor.** Kur binte shi e llohë, mblidheshim nëpër guva dhe atje **jehonin për bukurë këngët partizane.** Dhe kjo zgjati ndonjë vit e ca, gjer në ditën kur filloj hapja e rrugës Kukës-Peshkopi. Bashkë me vullnetarët e parë u nisa edhe unë për në aksion. Kur vajtëm në qytet, komandanti i brigadës s'deshi të më pranonte, se unë isha më i vogël nga të gjithë. Dhe meqë isha dhe pak i shkurtër nga shtati, nuk ja mbushja mendjen se mund të punoja për hapjen e rrugës së re. Kështuqë, kur më pa, më tha: «Ti, mor djalë, je pionier. Në aksion vinë të rintjtë, se atje shkojmë për të punuar e jo për të kënduar». Këtë fjalë e tha, ndoshta, se më kishte parë që unë, duke pritur të nisesha, këndoja më shumë se të tjerët. Po unë nuk e humba dhe ju përgjegja aty për aty; «Merrmë njëherë të më provosh dhe do të shikosh». «Epo mirë, — më tha. — Eja dhe ti. Tani edhe mosha sikur nuk ngre shumë kandar. Në çetë kemi pasur një partizan, thuajse në moshën tënde, që luftonte si të mëdhenjtë».

Aksioni për hapjen e rrugës Kukës-Peshkopi qe një shkollë e madhe për mua. Kur mbaroi turni ynë, nuk u largova me brigadën. Me dëshirën time qëndrova atje, gjersa mori fund hapja e rrugës dhe

u larguan të gjitha brigadat. Në atë kohë, në shtabin qendror regjistroheshin ata që donin të shkonin në kurse të ndryshme për të mësuar ndonjë zanat.

Nga aksioni i rinisë na nisën për në Tiranë. Mua më caktuan në një kurs për muratorë e karpentierë. Atje, hem mësonim në klasë, hem bënim praktikë për të përvetësuar zanatin.

Sapo mbaruam kursin, na dërguan në kantinerin e Selitës, në malin Dajt, pranë Tiranës. Atje, në një lirishte, ku kalonin shpesh derra të egër, nisëm të ndërtotonim disa baraka me dërrasa. Në ato baraka, që lëshonin ende një erë të këndëshme rrëshire, do të banonin ata që do të çanin tejpërtej malin për t'i dhënë Tiranës ujë e drithë. Kur u largova nga kursi, kujtoja se e dija mirë zanatin e muratorit e të karpentierit. Po atje e kuptova se zanati mësohet dhe përsoset në praktikë, në punën e përditshme. Sidoqoftë, isha i kënaqur që merrja pjesë në ndërtimin e një vepre aq të madhe, për të cilën flitej në gjithë Shqipërinë. Nga ana tjetër, tani isha në gjëndje të ndihmoja edhe shtëpinë. E si mund ta harroj unë atë ditë që mora rrrogën e parë dhe, pasi mbajta një pjesë për nevojat e mia, pjesën tjetër ja nisa familjes në fshat. Kjo kish qenë një ditë e shënuar për mua. Parafytyroja nënën që do të shkonte në zyrën e postës në qytet për të marrë lekët dhe më bëhej zemra mal. Pas nja dy javësh mora letër nga nëna.

Letrën e shkruante motra e vogël, po fjalët kishin dalë nga zemra e nënës. Duke lexuar letrën, nuk dija përsë të gëzohesha më shumë: për fjalët e nënës, apo që motra ime e vogël kish nisur të shkonte në shkollë. «Shtëpia jonë, — më shkruante

nëna me dorën e motrës, — qysh atë ditë që mbylli sytë yt atë, më dukej sikur qëndronte në hava dhe sikur nga çasti në çast do të rrëzohej përdhe. Se i mungonte shtylla. Po tani s'kam më frikë. Shtylla e shtëpisë më je bërë ti...» Kjo letër më bëri ta ndjeja veten burrë; në shpatullat e mia më duhej të mbaja shtëpinë. Dhe përsëri më vinin ndërmend fjalët e atij partizanit që ju kam folur. «Sa drejt i kishte parashikuar ato që do të ndodhnin dhe sa bukur më kishte folur!» — thosha me vete. Me këto mendime në kokë i përvishesha punës, sa që nuk e ndjeja lodhjen fare.

Një ditë, nga çatia e një barake që e mbulonin me letër katrama, pashë një njeri të gjatë me një valixhe në dorë, që shkonte drejt qendrës së kantierit. E vështrova njëherë mirë dhe, padashur ktheva kokën nga ana tjetër, ashtu siç bëjmë kur na del përpara befas një gjarpër. Për një çast ngela si i hutuar me sqeparin në dorë. «Të jetë ai me të vërtetë? — thosha me vete. — Nuk e besoj. Më kanë bërë sytë. Ç'kérkon ai këtu?»

Qe me të vërtetë pér t'u habitur. E si të mos habitesha, kur, pas katér-pesë vjetësh, shikoja atje, në kantier, njeriun që e urreja me gjithë shpirt! Besoj se e morët me mend se ishte i biri i çifligarit.

— Aaa! — u dëgjua një zë i mbytur nga habia. Marku qëndroi pér një çast, sikur kërkonte të kukohej pér diçka dhe, i gëzuar që e gjeti, vazhdoi:

— Po, po; ai ishte i téri. E që thoni ju, or shokë, unë ju përvasha përsëri punës dhe sikur e harrova atë fytyrë të urryer. Po, aty nga dreka, tek po laja duart në një çezmë pranë mensës, e pashë

përsëri. Ai sa po dilte nga mensa. Në mëngjez e kisha parë për së largu, kurse tani e kisha fare pranë. As dy hapa larg. E vështrova njëherë mirë e mirë. Dhe m'u rrënqeth trupi. Po, or shokë! Se nuk është shaka...

—Kjo u ngjan shumë atyre historive që le-
xojmë nëpër libra, — tha vajza e gjatë.

— Merre si të duash. Nëse ju po habiteni një herë tani që e dëgjoni këtë histori, unë jam habi-
tur njëqind herë më shumë, kur e pashë atë surrat
në kantier. Kishte veshur një xhaketë verore, që i
vinte mirë për trupi dhe një palë pantallona kilota
ngjyrë bizeleje, që bënин një kontrast të bukur me
xhaketën. Tamëm djalë zoterie; se mbahej ende nga
dhjami i vjetër i çifligarit. Afërmenc që atje, në
kantier, s'mund të vinte i pispllosur si njëherë
e një kohë këtu në plazh, apo në shtëpinë e të
jatit... Po, kur e pashë mirë, vura re se në
fytyrë tregonte si i vrarë. Si një njeri që mban
diçka të fshehir në shpirt, që e torturon shumë
dhe s'ka kujt t'ja kallëzojë...

E humbi për një çast kur i dola përpara, se
u takuam papritur. Unë, ç'është e vërteta, s'kisha
ndërmend t'i flisja. Po edhe ai qëndroi për një çast
si i pavendosur. Pas pak i shtyrë kushedi nga
ç'arësy, bëri dy hapa drejt meje e më tha me
një zë të butë e si përkëdhelës.

— Mos je Marku ti?

— Po, — ju përgjigja. — Unë jam Marku.

— Kü je, bre Mark! Ku je, bre djalë! —
thirri ai duke më shtrënguar dorën, ndërsa me
dorën e majtë më godiste lehtë në shpatulla me
një përzemërsi të shtirur. Desha njëherë të shkë-
puteshë nga duart e tij, t'i qëndroja serioz e t'i

thosha shkurt e prerë: «Ç'kërkon nga unë, zotëri? Po, unë jam Marku, shërbëtor i vjehrit tënd ish lopari, që më ke zhëdëpur në dru vetëm e vetëm se guxova të këndoja një këngë partizane. Mos ke harruar? Në qoftë se ke harruar ti, nuk harroj unë!»

Mirëpo, megjithëse më pëlqente ta quaja veten burrë, isha ende djalë i papjekur dhe s'i njihjë mirë njerëzit.

— Sa je rritur, sa je ndryshuar e zbukuruar!
— më tha ai. — E di, Mark? Në fillim kur të pashë, nuk të njoha dhe mendohesha: «Ku e kam parë këtë djalë?» Po shpejt më erdhi ndërmend e thashë me vete: «Ky me siguri do të jetë Marku ynë.»

Kur dëgjova këto fjalët e fundit tërroqa menjëherë dorën time nga dora e tij dhe i hodha një vështrim tërë inat. Ai e ndjeu se më kishte prekur në sedër, por vazhdoi përsëri me lajka:

— Si të mos habitesha, bre djalë? Ti je bërë alamet burri! Këtu punon tani? Të pashë në çatinë e barakës që po ndërtohej matanë. Shumë bukur! Shumë bukur! Karpentier, hë? Sa mirë. Ekstra. Ku ka më mirë se punëtor sot? Ja, edhe unë këtu do të punoj tani...

Dukej se kishte qejf të hapte bisedë të gjatë. Po unë ndjeja një neveri në shpirt e nga fjalët e tij më vinte si për të vjellë. Ndaj ja preva shkurt.

— Më fal, — i thashë me nxitim, — po tani kam një punë të ngutshme dhe më duhet të largohem.

— Posi, posi. Të shkosh menjëherë bile. Tani jemi në një kantier dhe do të takohemi përditë. Sa u gëzova që të takova këtu! Hajde, mirupaf-

shim! — më tha e më zgjati dorën. Po, pa u lar-guar mirë, ngriti zërin e më thirri.

— Mark! Po të kesh ndonjë nevojë, këtu më ke mua!

Unë s'ju përgjegja, po shpejtova hapin që të largohesha sa më parë, ndërsa me veten time thosha: «Po, pa dale! Ç'kérkon ai këtu? Përse ka ardhur, vallë? Mendja më thotë se s'ka ardhur për mirë; Kur e pashë që doli nga mensa, m'u duk si një çakall në mes të tufës...»

Kur gjeta rastin, pyeta një shok nga ata të administratës dhe ai më tha se djali i çifligarit kishte ardhur për punë. Ai do të punonte si gjemetër. Ju të rintjtë mos u çuditni. Asokohe ne kishim pak njerëz me shkollë. Prandaj merrnin edhe nga ata. S'do mend se ata nuk na donin të mirën dhe përpinqeshin të na dëmtonin. Po edhe ne nuk flnim, ama. Sytë i bëним katër.

— Po ai a bëri ndonjë punë nën rrugoz, apo e mblođhi mendjen top dhe u pajtua me gjendjen e re? — pyeti vajza që kishte ardhur bashkë me të dy tipografet.

— Nuk e besoj të jetë pajtuar, — u hodh e tha minatori.

— Nga e di ti? — ndërhyri Ademi.

— Nga e di unë? E marr me mend.

— Dëgjoni, or shokë, — e mori përsëri fjalën Marku. — Kjo histori ka aq shumë dredha e zig-zage, sa nuk mund ta merrni me mend. Ndaj mos u ngutni të nxirrni përfundime qysh tani. Dëgjoni njëherë gjer në fund, pastaj... Tani vetëm një gjë ju them: ai, biri i çifligarit, duke u përpjekur të sabotonte ngriti një kurth kundër meje, që për pak rashë brenda...

Ata që e dëgjonin, shikuani njeri tjetrin me habi. Në sytë e të gjithëve pasqyrohej padurimi. Historia e Markut po u pëlqente pa masë.

V. — NË KANTIER VJEN «HASMI»

Kishin kaluar nga gjashtë muaj nga koha kur kisha vajtur në kantier, kur një ditë erdhi një kamion me një grup të madh punëtorësh. Në dolëm në shesh të kantierit se mos gjenim ndonjë shok a ndonjë bashkëfshatar. Midis tyre unë dallova një fytyrë shumë të njojur dhe frap! — më theri në zemër.

Pa dashur u ndala në vend dhe përnjëherësh u ktheva mbrapsht. Edhe ai, i njouri im, bëri sikurnuk më pa dhe u fut midis njerëzve. Po herë-herë kthente kokën nga ana ime e më ndiqte me sy.

Tani ndonjëri prej jush mund të pyesë: «Gjerasa e kë pasur të njojur, si nuk u ndale të takoheshe me të?» Të porsaardhurin nuk e kisha vetëm të njojur, po edhe bashkëfshatar. Bile edhe komshi. Kullat tona ngriheshin pranë e pranë majë një kodreje të zveshur. Megjithatë, nuk kishim këmbyer kurrë një fjalë midis nesh, as kur ishim fëmijë të vegjël dhe as më vonë kur e quanim vreten burra. Ju duket pak si e pabesueshme, a? Dëgjoni, pra, se si qëndronte puna. Mbani mend që ju thashë në fillim se im atë kërkonte gjithnjë punë sa më larg fshatit? Këtë ai nuk e bënte pa arësy. Më kuptioni? Shkaku i vërtetë ka qenë një hasmëri e vjetër e familjes sime me familjen e Kolës, kështu quhej ai burri që erdhi atë ditë në kantier. Shikoni, pra, se si mpleksen ngjarjet e kësaj his-

torie, që kanë ndodhur vite më parë. Nga sa nata tregonte gjyshja kur ishim të vegjël, ne kemi qenë nga një fis me familjen e Kolës. Mirëpo të dy familjet tonë u ndanë dhe u bënë armike midis tyre. Pse, do të thoni ju. Për hiç gjë; ju betohem, ore shokë, pér hiç gjë. Pér punën e ndarjes së ujtit pér ujtitjen e një are... Më kuption? Punë boshe, fare.

Ata të familjes së Kolës kishin vrarë vëllanë më të madh të babait tim, kurse tanët vranë të jatin e Kolës. Kjo histori gjaku vazhdoi për një kohë të gjatë dhe nuk do t'ë merrte fund kurrë, po të mos kishin zbritur partizanët nga malet me fjalën e Partisë në gojë.

Asokohe, me që isha i vogël, nuk ndjeja ndonjë hasmëri për ata të familjes së Kolës, as për vetë Kolën. Po, meqë njerëzit e shtëpisë sonë i quanin hasmë, edhe unë i shikoja me bisht të syrit e me mosbesim. Kur u çlirua vendi dhe unë u ktheva nga qyteti në shtëpi, u fol shumë edhe në fshatin tonë, se kishte ardhur koha që hasmëritë tē harroheshin e të shuheshin fare. Për këtë flisin tē gjithë. Mirëpo, nga sa thoshin atëhere, xanhxai i Kolës kishte thënë: «Gjaku nuk lahet as me fjalë, as me konferenca: gjaku lahet vetëm me gjak. Ata të familjes së Prenkës (ashtu quhej gjyshi im) na kanë borxh. Le ta lajnë njëherë atë borxh, pastaj shohim e bëjmë».

Dhe e dini kush e kishte tanë radhëën për të paguar borxhin? Unë! Po, unë! Se unë isha i vetmi mashkull i shtëpisë. Sipas zakonit duhej të vritesha unë nga ndonjë burrë i derës së tyre, të themi nga dora e Kolës.

— E tmerrshme! — thirrën vajzat.

— E tmerrshme, po e vërtetë. Të themi atë që është. Atëhere nuk u kisha dhënë shumë rëndësi thashethemeve që ishin përhapur në fshat. Po, kur pashë Kolën në kantier, më lindi menjëherë dyshimi: «Mos ka ardhur vallë, të marrë hakun?» — thashë me vete i shqetësuar dhe për disa ditë me radhë jetova me ankth në zemër. Herë-herë më mbushej mendja se ai, i shtyrë nga njerëzit e tij, kishte ardhur për hakmarrje; po, kur e shikoja që ai i përvishej punës me gjithë zemër, sikur i largoja ato dyshime të kobshme. Po si mund ta sqaroja se si qëndronte e vërteta? Më vinte turp të bisedoja me shokët e mi të punës, se gjithë kjo histori më dukej aq e neveritshme, sa s'tuhet dot me fjalë. Për një kohë mjaft të gjatë kam bërë çmos që të mos e takoja Kolën, as në punë, as në mensë, as në rrugë. Në mensë shkoja pak më vonë se të tjerët. Në sheshin e kantierit, ku mblidheshin zakonisht punëtorët, nuk qëndroja shumë dhe në klub futesha sa për të marrë ndonjë paqetë cigare. Po e dini sa e vështirë ka qenë kjo përmua? Se nuk është puna për një a për dy ditë, po për një kohë shumë të gjatë. Sado që përpiquesha të mos e hasja gjökundi, kjo gjë s'mund të vazhdonte përgjithnjë. Ne rronim në një kantier, hanim në një mensë dhe shumë herë punonim në të njëjtin turn. Unë si karpentier për të bërë armaturat dhe ai si zjarrmëtar.

— Ç'është zjarrmëtar? — pyeti vajza e shkurtër.

— Zjarrmëtar është ai që ndez minat, — u përgjegj në vend të Markut minatori. — Kur hapen galeri, goftë për të nxjerrë mineral, goftë për të çarë malin, që të kalojë uji për ndonjë hidrogen-

tral a për ndonjë ujësjellës, përdoren mina. Dhe ai që u ve zjarr minave quhet zjarrmëtar.

— Po, — vazhdoi Marku, — kështu është. Zjarrmëtar shkon gjithnjë sé bashku me armatorin e galerisë dhe me minatorin. Poo! Dhe ja c'më ndodhi një ditë me Kolën. Unë dilja nga tuneli me veglat e punës në dorë, kurse Kola në atë çast hynte në tunel për të r.dezur minat. E vë-shtrova njëherë me bisht të syrit dhe bëra më-njanë. Edhe ai më hodhi nxitimthi një shikim të shpejtë dhe humbi në errësirën e tunelit. Ishte hera e parë që ndeshnim njeri-tjetrin nga afër. Ai ktheu një herë kokën e më shikoi në sy. Edhe tani e mbaj mend atë vështrim që ma hodhi vetë-timthi. E vërteta është se ai nxiton, mbasi e kishin lajmëruar se minat qenë gati për zjarr dhe nuk duhej të humbiste kohë. Po mua m'u duk pikur ai më shikoi me inat, me urrejtje. Ndoshta ashtu më është dukur, po, sidoqoftë, ai takim te hyrja e tunelit m'i shtoi dyshimet dhe më bëri tē ruhesha më shumë.

Po si mund tē ruhesh nga një njeri kur rron e punon në një kartier. Kantieri, sado i math që tē jetë, i afron dhe i bashkon njerëzit për ditë më shumë; kurse me mua e me Kolën ndodhë e kundërsa. Ne qëndronim karshi njeri-tjetrit si armiq...

Kjo gjë nuk mund tē mos tērhiqtë vëmëndjen e tē tjerëve. Shumë njerëz, nga ata që punonin rë kantier, e nuhatën se midis nesh kishte diçka tē keqe e tē fshehtë dhe r.isën tē na pyesnin. Kur mësuan tē vërtetë, nuk ishin tē pakët ata që na qortuan. Bile pati dhe shokë që u përpoqën tē na pajtonin. Sidomos njëri ka bërë çmos që ta rrëgullonte një herë e mirë këtë punën tonë...

Ai nuk ishte i vjetër nga mosha, por i thijnjur në kokë. Kozma e kishte emrin, por të gjithë e quanin Bolshevik.

Dhe nuk ja kishin nxjerërë kot këtë emër. Nga sa flitej në kantier para çlirimt kishte punuar në puset e nxjerjes së naftës në Kuçovë dhe kishte luftuar me mish e me shpirt për të drejtat e punëtorëve. Prandaj në kohër, e Zogut e të Italisë e kishin kapur disa herë dhe e kishin hedhur në burg, ku e kishin rrahuar për vdekje... Në kohën e luftës ai kishte qenë partizan dhe, në një përlleshje me gjermanët ishte plagosur në këmbë.

Bolsheviku merrej me punën e kuadrit në kantier; ai punonte edhe për sqarimin dhe edukimin e njerëzve. Se ai ishte njeri i Partisë. Megjithëse i çalë, atë e gjenje kudo, në të gjithë sektorët e kantierit...

Një ditë ndodhi një vrasje për hakmarrje në një fshat të malësisë së Martaneshit. Bolsheviku na mblodhi e na foli për këtë ngjarje të shëmtuar. Dhe jo vetëm na foli por na shpjegoi gjerë e gjatë se ku qëndronin rrënjet e zakonit të keq të hakmarrjes. Në atë mbledhje mua m'u duk sikur ai nuk i hiqte sytë nga unë. Dhe ndjeja një turp që s'thuhet me fjalë.

Pas nja dy ditësh Bolsheviku më takoi e më pyeti për çështjen e hasmërisë sime me Kolën. Unë ja kallzova krejt historinë. Ai më dëgjoi me vëmendje. Në fund më tha:

— A nuk është turp, o Mark, të mbajmë të fshehura në shpirt hasmëritë e vjetra?

— Turp i madh është — pranova unë dhe ula kokën.

— Ne kemi luftuar dhe jemi çliruar nga ar-

miq tē egér e barbarë, siç qenë fashistët italianë, e gjermanë. Si do tē pranojmë ne tē mbetemi skllevër tē këtyre zakoneve tē vjetra, që na sjellin dëme shumë tē mëdha...

Dëgjo, Mark! Unë do tē bisedoj edhe me Kolën. Dhe po tē jetë nevoja do t'ju thërras ndonjë ditë që tē dy që ta rregullojmë njëherë e mirë këtë çështje.

Unë i thashë se s'kisha asnë kundërshtim dhe me kaq biseda jonë e parë mori fund. Bolsheviku do ta kishte bërë këtë punë dhe, ndoshta, ngjarjet, që u rruckullisën më vonë, do tē kishin marrë një rrugë tjetër. Por pas disa ditësh atë e dërguan në shkollën e Partisë në Tiranë, ku qëndroi nja gjashtë muaj.

Kur u kthye përsëri në kantier as që flitej më për këtë çështje. Kantieri ziente nga puna e madhe për tē çarë tejpërtej malin Dajt. Njerëzit s'kishin kohë që tē mirreshin me hasmëritë e vjetra. Edhe unë vetë, duke u marrë për ditë me punëra tē tjera sikur e harroja këtë histori. Edhe kur më kujtohej ndonjëherë më dukej sikur pajtimi im me Kolën do tē vinte dalëngadalë, me katinim e kohës. Mirëpo nuk ndodhi kështu. Ngjarjet nuk morrën atë rrugë që dëshironin e shpresonin miqtë dhe dashamirësit tanë. Se pikërisht atëhere kur u duk se ky prush i vjetër po shuhej, doli një dorë e fshehtë, që me një mashë në dorë, përpiquej tē nxirrte ndonjë xixë nga thëngjilli i fundit, që ende nuk ishte shuar fare. Hesapin e kishte bërë mirë me vete. Do tē mjaftonte vetëm një xixë që tē ndizej përsëri flakadani...

Tani besoj se nuk e keni vështirë ta kuptoni se ajo dorë që mbante mashën ishte dora e gjeo-

metër Petritit. Ai ishte usta i regjur në kësi punësh. Dhe punën e bënte tinëz, me marifet. Kështu që nuk e nuhatëm dot me kohë as unë as të tjerët...

Unë kisha vënë re një ndryshim në sjelljet e tija karshi meje. Para se të mirrte vesh hasmërinë time me Kolën, ai nuk linte rast që të më afrohej. Në çdo gjë tregohej shumë i dashur me mua. Kudo që më shihte, qoftë edhe së largu, qëndronte menjëherë, më shtrëngonte dorën e bënte sikur më fliste me dorë në zemër, si njeri i afërt, si njeri i familjes. Ke parë ti... Bile disa herë që ishim takuar në klub, kishte ngulur këmbë që të më qeraste me pije të shtrënja. Po unë, sado i papjekur që isha në atë kohë, ndjeja një neveri të thellë dhe nuk pranoja asgjë prej tij. Jo vetëm kaq, por bëja çmos që të qëndroja sa më larg. Por ai vazhdonte të tijën. Bile një ditë m'u afrua e më tha me një interesim të shtirur: «Mark! Ç'ke ti që nuk flet me Kolën?» «Nuk kam gjëkafshë — ju përgjegja me gjakftohtësi. «Si s'ke gjëkafshë? Në kantier flasin të gjithë se jeni në gjak me njëritjetrin» «Këto janë histori të vjetra, që u ka kaluar koha» — i thashë shkurt dhe bëra të largoheshë. «Unë të dua të mirën, prandaj t'i them këto gjëra» vazhdoi ai duke më kapur nga dora. «Dëgjo! Unë e di mirë kush ma do të mirën dhe kush ma do të keqen — i thashë prerasi dhe u nisa për t'u larguar, ndërsa ai vazhdonte të llomotiste: «Kot e ke që rrëmbehesh, or djalë. Unë desha të të këshilloja, të të tregoja një rrugë për të shpëtar nga hasmi...»

— Maskarai — murmuriti me zemërim të përmbytjut minatori.

— Dëgjo se ç'bëri më vonë, pa — vazhdoi Marku. — Unë e kisha vënë re edhe më parë se ai shoqërohej me Kolën. Po, pas asaj bisede, sikur ta bënte për inatin tim, ai u lidh më ngushtë me «hasmin» tim. Nuk linte rast pa u takuar dhe pa biseduar me të, Shumë herë e merrte Kolën me vete dhe shkonin në klub ose dilnin në një lëndinë, që shtrihej pak më lart se barakat e kantierit. Ngandonjëherë, në ditët e pushimit, bënин së bashku shëtitje në një rrugë të bukur pylli, që të nxirrte në një lirishte të madhe e të bukur; atje ata shtriheshin mbi barin e njomë e bënин biseda të gjata.

Kjo u ra në sy të gjithëve; po më shumë nga të gjithë më bënte përshtypje mua. Më shkonte ngandonjëherë në mendje se ai e shtynte Kolën që të mos pranonte të pajtohej me mua. Por s'kisha si ta vërtetoja.

T'ju them të vërtetën, kur i shikoja të dy së bashku më vinte keq për Kolën. Unë dija shumë gjëra për gjeometrin, të cilat Kola as që mund t'i merrte me mend.

Dy-tri herë u mata ta ndaloja Kolën në mes të rrugës, t'i shtrëngojë dorën e t'i thosha: «Or Kolë! Gjer kur do të mbetemi ne të dy rob të zakoneve të vjetra? Ne tani punojmë në një kantier, hamë në një kazan, punojmë në të njëjtin tunel. Çdo gjë na bashkon dhe asgjë s'na ndan. Mendo njëherë. Pastaj dua të të them edhe diçka tjetër, or vëlla. Gjeometër Petriti është njeri i lig. Unë e njoh mirë qysh para çlirimt.

Ai, or byrazer, të vret natën e të qan ditën...»

Mirëpo nuk e di përse më ishte ngulur në mendje që Kola do të më përgjigjej pak a shumë kë-

shtu: «Nuk të besoj, bre, jo! Ti e urren atë, prandaj më flet kështu».

Kështu, pra, unë nuk e bëra këtë hap vendimtar që t'i flisja Kolës çiltas dhe hapur. Tani e ndjej thellë gabimin që kam bërë, kurse atëhere më dukej se në fytyrën e Kolës nuk shikoja asnje shenjë, që të tregonte dëshirë pajtimi. Dhe kjo më shqetësonte shumë; se kjo qe për mua si një dëshmi, që tregonte se qe një hasmëri në heshtje, pa zhurmë e pa bujë, por që mund të shpërthente në befasi...

Por tani që kanë kaluar kaq vjet dhe i gjykoj më mirë gjérat, po bindem gjithënjë më shumë se gabimi im më i madh ishte se nuk i pata folur sa duhet Bolshevikut. Atij duhej t'i flisja për të gjitha. Dhe sidomos për të kaluarën e gjeometër Petritit. Asnjë tjetër nuk e dinte më mirë se unë biografinë e këtij armiku të fshehur. Prandaj edhe ai më kishte si halë në sy dhe kërkonte të më hiqte qafe.

Po t'i kisha folur me kohë Bolshevikut, ai do të vepronët dhe do ta ndalte atë dorë mizore... se që ta kuptioni mirë këtë histori, duhe të dini se gjeometër Petriti kish ditur t'i fshihte mirë të palarat e tij. Kjo doli më vonë, pasi u zbulua veprimtaria e tij. Atëhere e mora vesh unë se as Bolsheviku nuk dinte gjë për të kaluarën e gjeometrit. Se ai, or vëlla, kishte bërë çmos që të mbulonte çdo gjurmë që lidhej me aktivitetin e tij të mëparëshëm. Në kantier kërkonte të dukej sikur punonte me mish e me shpirt. Jo vetëm kaq, por shtirej sikur ishte njeri i thjeshtë dhe i lidhur shumë me punëtorët. Lere pastaj nëpër mbledhje e nëpër konferanca. Brisk e kishte gjuhën. Si njeri me shkollë që ishte, dinte ta vërtiste fjalën si të donte. Kështu që njerëzit gënjeleshin edhe e merrnin për njeri të

mirë. Edhe unë që ja dija mirë sojin e sorollopin thosha ngadonjëherë me vete: «Mos është penduar vallë, me të vërtetë dhe është bërë njeri i mirë?».

Mos u habitni pér këto që ju them. Atëhere sapo kishin kaluar tre-katër vjet nga dita e çlirimt dhe ka pasur ende njerëz që në dritën e ditës bënin sikur mbaronin punën tonë kurse në errësirë e në fshehtësi punonin pér armikun. Këtë do ta kuptioni më mirë kur të dëgjoni sesi u zhvilluan ngjarjet më vonë.

Një ditë, si zakonisht, hyra në tunel me veglat e karpentierit në dorë, pér të vazhduar armaturën. Kisha bërë mjaft rrugë dhe po i afrohesha vendit ku do të punoja. Sa më thellë hyja, aq më i vështirë bëhej të ecurit. Natën kishte shpërthyer uji me rrëmbim dhe gjithë tuneli i ngjante një përrroi të nëndheshëm. Në trup ndjeja nga të gjitha anët cirkat e ujit dhe notinë e tunelit të thellë. Befas dëgjova një zë të fortë, që në qetësinë e tunnelit jehoi me të madhe: «Kujdes, shok! Atje ka një gropë!» E njoha nga zëri që ishte Kola. Bëra mënjanë që të mos fundosesha dhe padashur i kaloja fare pranë. Në gjysmëerrësirë i hodha një shikim dhe menjëherë ula kokën. Nga se do të thoni ju? Nga turpi, or shokë! Po, nga turpi! «Po ai ç'bëri?» — do të thoni ju. Ai më shikoi, gjersa humba në errësirë. Nuk mund t'ju them se ç'ndjente në atë çast në shpirt. Vetëm një gjë mund të them me siguri: sytë e tij nuk tregonin urrejtje. Pér këtë gjë m'u mbush mendja që atë çast. Dhe u bëra gati t'i flisja. Po përsëri nuk i fola. As ai nuk më foli. Pse s'i fola unë i pari? Ja që edhe unë kisha sedër të sëmurë. Unë prisja të më fliste Kola i pari. Një forcë e padukshme ma mbante

gojën tē mbyllur e më thoshte: «Gjersa nuk tē flet ai, pérse t'i pérulesh e t'i flasësh i pari?

Më vonë u takuam edhe njëherë tjetër. Pérseri në tunel. Unë punoja pér tē rregulluar armaturën në një vend që kishte dalë si bark. Nga kreu i tunelit dëgjova zërin e fortë tē Kolës: «Minaaaa! Minaaaa!» Pas pak kaluan me vrap një grup minatorësh. Unë isha duke pérfunduar punën e turnit. Në atë çast isha duke sharruar një trá tē trashë dhe u vonova edhe disa sekonda. Ai që largohet i fundit nga vendi i shpérthimit tē minave është gjithnjë zjarrmëtari. Dhe zjarrmëtari ishte Kola.

Para se tē lija sqeparin, dëgjova zërin e tij tē fortë: «Shpejt tē dalim, shok!» Vrapova edhe unë pas tij dhe që tē dy arritëm te gryka e tunelit. Menjëherë shpérthyen minat me rrapëllimë. Në atë çast edhe zemrat tona rrahën bashkërisht. Po përséri nuk folëm. Ai u fut në tunel, prej nga dilnin ende re tymi, kurse unë mora rrugën e kthimit drejt kantierit. Ja, kështu ndodhi.

Të gjitha këto më bënин tē shpresoja se edhe Kola po e harronte dalëngadalë hasmërinë e vjetër, në mos e kishte harruar fare. Vetëm një gjë më bënte tē mos isha i qetë. Takimet e tij me gjeometrin vazhdonin si dhe më parë. Sa herë që i shikoja bashkë më ndillte zemra se nga këto takime nuk do tē dilte ndonjë gjë e mirë. «Ai diçka po kurdis», — thosha me vete. — Po si e çfarë nuk mund ta merrja me mend. Njëherë që bisedova me një mik dhe i shfaqa këto dyshime, ai m'u përgjegj. «Nuk e ke keq. Gjersa e ka zemrën katran, ashtu si thua ti, çmund tē presësh nga ai? Po s'ma merr mendja se do tē guxojë tē bëjë ndonjë gjë, sepse këtu jemi mëse treqind punëtorë.

Pra, gjashtëqind palë veshë dhe gjashtëqind palë sy për të kapur çdo gjë të dyshimtë.

U qetësova nga fjalët e mikut. Atëhere as mua, as mikut tim nuk na shkonte mendja se skilja e vjetër po e ngrinte me mjeshtëri kurthi.

VI. PËLHURA E MERIMANGËS

Jeta në kantier vazhdonte me vrull e gjallëri. Ditët e javët kalonin dhe mali i Dajtit nga jashtë dukej se s'kishte pësuar asnjë ndryshim. Mirëpo, në thellësi të tij, ndodhnin ndryshime të mëdha. Hidrocentrali dhe ujësjellësi që po ndërtonim, po tërhiqnin vëmëndjen e të gjithëve. Për të flisnin të mëdhej e të vegjël anembanë vendit. Puna në tunel kishte ecur shumë përpëra. Disa nga ato ishin çarë tejpërtëj, disa të tjera ato më të vështirat, ishin në fazën e fundit. Ne gëzoheshim pa masë kur shikonim se, nën goditjet e duarve tonë, po mposhteshin malet shkëmbore e shekullore...

Sa më e vështirë që bëhej puna në thellësi të tuneleve, aq më shumë hidheshin në punë punëtorët e kantiereve tona. Duart e njerëzve tanë ndesheshin përditë me shkëmbin e ashpër dhe tregoheshin më të forta se ai: se, në thellësi të shpirtit të punëtorit, ishte ndezur një flakë, që i nxitte ata të bënin mrekullira. Atëhere dualën «luanët e maleve». Po toka s'mban vetëm luanë; në baltën e saj fshihen edhe krimba...,

Gjeometër Petriti punonte me gjithë shpirt për të kryer detyrat që i takonin. Çdo ditë bashkë me minatorët, futej thellë në tunele, bënte matje, mbante shënimet e jepte udhëzime. Në orët e lira

bënte çmos që t'u afrohej punëtorëve e të tregohej shumë i dashur me ta. Tani, përveç Kolës, shoqërohej edhe me mjaft punëtorë të tjerë.

Një natë ra një shi i rrëmbyer dhe, nga fryrja e një përroi, na u prish një urë që të conte në tunel. Ura duhej të ndreqej menjëherë, sepse pengohej transportimi i materialeve. U dha alarmi dhe vrapuam të gjithë. Atje pashë gjeometër Petritin që, i mbathur me një palë çizme të gjata, po futej thellë në përrua për të caktuar vendin e shtyllave të urës. Kur e pashë ashtu të lagur në mes të përroit, thashë me vete: «Ndoshta ka ndryshuar edhe ai. Duke jetuar midis nesh dhe duke parë se ç'po bëhet, do ta ketë kuptuar se nga q'anë qëndron e vërteta. Shumë mirë, pra. Si duket e hoqi lëkurën e vjetër dhe po bëhet njeri i mirë». Në atë çast nuk më vajti hiç në mëndje se edhe gjarpëri e ndërron lëkurën një herë në vit, po helmin e mban gjithnjë, në majë të dhëmbit...

Dhe ja s'pashë një herë tjetër. Ishte një ditë e bukur vjeshte, e butë si në pranverë. Ishte e dielë dhe kisha dalë shetitje në një lëndinë që shtrihej mbi kantier. Rretherrotull, pylli madhështor kishte një bukuri të rrallë. Horizonti qe i qartë dhe syri arrinte në një largësi shumë të madhe. Në këmbë të Dajtit shtrihej Tirana, e praruar nga rrezet e arta të diellit të vjeshtës. Më tutje fushë, bregore, përsëri fushë e përsëri bregore gjer atje larg, ku deti dallohej si një pasqyrë pambarim. Duke sอดit tur këtë panoramë të bukur, mora të përpjetën përt'u ngjitur mbi një shkëmb që ngrihej madhështor buzë pyllit. Kur ju afrova shkëmbit, dëgjova zëra njerëzish. Menjëherë dallova zërin e tij, zërin e gjeometër Petritit. Ai qe ulur majë shkëmbit ba-

shkë me një teknik tjetër e me një financier të vjetër dhe u tregonte me zë të ulët. Bëra edhe disa hapa përpara dhe dëgjova se u kallëzonte ngjarje ngajeta e rinisë. Duke shikuar detin prej së largu, u fliste për ditët e bukura që kish kaluar nëpër plazhet, si në plazhet e vendit, ashtu dhe në ato të Italisë. Deti, që dallohej qartë lart nga mali, më zgjonte edhe mua njëmijë kujtime të fëminisë, po kujtime të hidhura. Padashur u ndala në vend. Pas pak ndërrova drejtim e u futa në një pyll duke menduar: «Me ç'mall flet për jetën që bënte atëhere! Afërmenç se ai s'mund t'i harrojë lehtë ato ditë të lumtura për të e familjen e tij. Prandaj s'mund të shkëputet nga ajo botë e përbysur.»

Kështu, nuk kaluan shumë ditë dhe në kantier ndodhi diçka që ja hoqi petët lakrorit...

Marku qëndroi një çast, u hodhi me radhë një shikim të shpejtë dhe, kur pa se të gjithë prisnin me padurim të dëgjonin përfundimin e kësaj historie, ngriti zërin e vazhdoi:

— Punimet në kantier kishin arritur kulmin. Nga sektorët e tjerë të ndërmarrjes kishin ardhur përforcime. Tuneli kryesor ishte në përfundim. Pritej që mali të çahet tejpërtej. Po të mos ndodhët ndonjë gjë e papritur, parashikohet që, pas nja dy javëve, të bashkoheshim me ata që çanin nga ana e kundërt e malit. Kjo do të ishte një ngjarje shumë e rëndësishme. Të çahet mali tejpërtej, do të thoshte të zhdukeshin dyshimet e shumë njerëzve, që ende nuk e besonin se mund të bëhej një gjë e tillë. Asokohe ka pasur edhe punëtorë që thoshin: «Si është e mundur që të bashkohemi me ata që vinë nga ana e kundërt? Ku dimë ne këndeje se ku çajnë ata nga ana tjetër e malit? E ku mund të dinë

ata në ç'drejtim përparojmë ne?» Edhe diçka tjetër. Hapja e tunelit do të ishte një shuplakë e mirë për ata që s'na donin të mirën, për ata që shpresonin se ne do të dështonim në ndërtimin e hidrocentralit të parë të madh në vendin tonë. Dhe kjo nuk ishte gjë e pakët.

Ne që punonim atje, e prisnim ditën e takimit me shokët që çanin malin nga ana e kundërt si një ditë të shënuar, si një festë të madhe. Të gjithë njerëzit e kantierit jetonin si në pritje të një ngjarjeje të jashtëzakonshme. Dhe punonin ditë e natë, që ai çasti i lumtur të vinte sa më parë. Se festat e tjera kanë një datë të caktuar, që s'mund të ndryshohet; ndryshe nga ato, festa e madhe që prisnim ne, varej nga duart tonë, nga puna jonë. Po të punonim me vrull dhe çdo gjë të shkonte në rregull, festa do të vinte sa më parë. Ndryshe. . .

Një ditë minatorët kishin përparuar më shumë se herët e tjera. Kola, si zjarrmëtar, shkontë e vinte me nxitim në tunelin e errët. Përparimi i minatorëve na hapi ne, karpentierëve, shumë punë në armaturë. Kishim ditë që punonim në një sektor të vështirë, ku buronte ujë nga të gjitha anët. Po mendimi se ishim në përfundim të tunelit na jepte krahë e na bënte të punonim me entuziazëm të madh. Pengesat dhe vështirësitë në punë s'na trembnin. Asokohe më kishin caktuar brigadier të karpentierëve të turnit të dytë dhe kisha shumë telashe. Po kur shpirti i punëtorit ndizet flakë, të gjitha telashet, sado të mëdha që të jenë, zhduken. Orari i turnit ishte në përfundim. Ne vazhdonim të punonim me ngulm; që të përfundonim armaturën para se të vinin minatorët e turnit të parë. Siç e

dini edhe ju, njeriu që punon në tunel, nuk e di
në është natë apo ditë. Edhe ne kishim hyrë në
tunel ndaj të ngrysur dhe nuk e dinim mirë në qe
gdhirë jashtë, apo ishte ende errësirë. Ata që tran-
sportonin me dekovil dërrasa e trarë nga gryka e
tunelit gjer te vendi i punës, nuk na thoshin asnje
fjalë. Shkarkonin me nxitim materialet dhe nise-
shin me ngutje për te gryka e tunelit. Po njeri nga
ata u ndal një çikë e më tha:

— Mark, pa shiko se ç'dërrasa kanë sjellë atje
jashtë!

Unë zura një dërrasë me dorë dhe u bëra
nervoz.

— Ç'janë këto dërrasa, bre Maksut?! — i thi-
rra. — Këto janë për të bërë tavan nëpër dhomat
e pritjes e jo armaturë në tunel.

— Ashtu them edhe unë.

— Po pse muarët nga këto?

— Se s'ka të tjera. Edhe nga këto nuk kishte,
po ka ndonjë orë që erdhi një kamion dhe solli
prapë. I fola atij që i shkarkonte, po e di si m'u
përgjegj? «Hajde tani, mos bëj potere. Këto dërrasa
i pa edhe gjeometri dhe tha se bëjnë, sepse janë
prej lisi».

— Këto prej lisi?! — thirra unë se nuk mbajta
dot veten. — Hajde, hajde, gjeometër!

Në atë çast erdhi me vrap një njeri, i cili, me
t'u afruar, thirri:

— Brigadier, të kërkojnë tani në kantier!

— Mua? Pse?

— Nuk e di. Të vish menjëherë në drejtori.

— Qëmenatë më kërkojnë? — thashë unë, me habi.

— Çfarë natë, o brigadier! — foli ai duke qeshur. — Jashtë ka rënë dielli.

Ç'të bëja? «Po dal, — u thashë shokëve, — të shikoj se q'më duan dhe të kujdesem edhe përdërrasat». Te gryka e tunelit pashë një stivë dërrasash të holla, si ato që kish sjellë Maksuti brenda në tunel. Dërrasa të tjera nuk kishte. «Ç'u bënë dërrasat e vjetra që ishin mbrëmë këtu?» — thashë me vete. Dërgova Maksutin në depon e materialeve me porosi që të ngarkonte një maqinë me dërrasa të mira. «Përndryshe, — i thashë, — të ndërpritet armatura». Atje, te hyrja, pashë edhe Kolën që priste gjersa të vendoseshin minat, që t'u vinte zjarrin. Ashtu si edhe herët e tjera, nuk më foli. Edhe unë nuk i fola. E ndjeja veten si në gjemba. Si të bëja? Dërrasat nuk bënин përmarmaturë; pondërpërje e punës do të sillte një vonesë të madhe në përfundimin e tunelit. I dërguari nga kantieri më nxiste të nisesha sa më parë përmë drejtori. «Të kërkojnë shpejt», — më tha edhe një herë atje, te gryka e tunelit dhe u çduk. Unë u nisa përmë në kantier.

Do të kisha bërë nja treqind metra rrugë, kur pashë gjemmetër Petritin që i ngjitej një monopati përmë të shkuar në tunel. Po nuk i folëm njëri-tjetrit, se ishim mjaft larg. «Gani ai shkon atje dhe me siguri do ta rregullojë punën e dërrasave», — thashë me vete dhe mora tatëpjetën drejt kantierit. Rruga ishte mjaft e gjatë, po unë e bëra përmë një orë e ca. Hyra në barakën e drejtorisë dhe kalova zyrë më zyrë përmë të gjetur se kush më kërkonte. Ai që më kishte lajmëruar nuk dukej gjékundi. Kjo më bëri

të dyshoja. Nja dy herë që e kisha pyetur se kush më kërkonte, ai më ishte përgjegjur: «Në drejtori». Mirëpo drejtori s'ishte në kantier dhe kryeinxhineri, që e zëvëndësonte, nuk dinte gjë. «Pa shiko, — më tha, — se mos të kërkojnë në zyrën e kuadrit». Vajta në zyrën e kuadrit, po edhe atje s'dinin gjë. U futa edhe në disa zyra të tjera të drejtorisë së kantierit, po asnjeri nuk dinte se kush më kishte kërkuar. Dola në sheshin e kantierit dhe po rrija i menduar. Ç'të bëja? Të prisja aty apo të ikja? Vështrova njëherë rrertherrotull se mos e gjeja atë që më kishte lajmëruar, po nuk e pashë gjë-kundi. «Po kush qe ai?» mund të thotë dikush. Unë nuk ja dija as emrin. «Po pse i besove? — do të thoni ju. E po ja, këtu qëndron gabimi im. Ç'është e vërtetë, në kantier kishte lëvizje të madhe njerëzish dhe në çdo punë e në çdo sektor mund të shikoje gjithnjë fytyra të reja. Po, sidoqoftë, unë mund t'i thosha atij: «Kush je ti, or shok?» Siç ju thashë, unë i besova atij menjëherë dhe u nisa pér në kantier. Sa jam penduar më vonë pér këtë! Jam penduar se pas pak ndodhi ajo që ishte pregatitur prej kohe. Unë isha duke pritur në sheshin e madh para drejtorisë së kantierit, kur erdhi lajmi i zi: «Në tunel ka ndodhur një shembje e madhe!», — tha një punëtor që mbërriti me një frymë nga sektori pér hapjen e tunelit.

E dini ç'do të thotë shembje në tunel? Katastrofë do të thotë, që, pér një sekondë, të shkatërron punën e një muaji. Leri pastaj po të ketë edhe viktima. Mund ta merrni me mend tani tronditjen time. Pér një çast m'u errën sytë dhe m'u muarën mendtë. Po shpejt e mora veten dhe ja dhashë vrapi. Nuk besoj të kem vrapiuar aq shpejt ndonjë-

herë tjetër në jetën time, sa atë ditë. E përpjeta thikë e malit më dukej si një fushë e rrafshët. Kur mberrita te gryka e tunelit, pashë një turmë të madhe njerëzish. Mora vesh se qenë plagosur tre veta. Që të tre nga brigada ime. Dhe puna në tunel qe ndërpërë. Të plagosurit po i mbartnin ne tezga për në qendër të kantierit dhe së andejmi për në spital. Unë u bëra gati t'u shkoja pranë, t'i përqafqoja si vëllezër e t'i shoqëroja gjer në spital. Po shpejt e kuptova se më duhej të qëndroja aty. Bile njëherë desha të hyja në tunel, të shikoja me sytë e mi dëmin që ishte bërë, dhe, bashkë me shokët e tjerë të brigadës, t'i përvishesha punës për heqjen e dheut që kishte rënë nga shembja. Kështu mund të vazhdonte puna menjëherë. Mirëpo s'më la ai, gjeometër Petriti. «Mos hyrë, — më tha me të ashpër. — Pritet të vijë një komision për të hetuar çështjen». Më theri mu në zemër. Jo sepse do të vinte komisioni, po nga mënyra se si më foli. Desha njëherë ta kapja nga fytì e t'i thosha: «Dhelpër! Se mos të dhimbisen vërtet ty shokët e plagosur? Se mos të vjen keq ty për dëmin që është bërë?»

Njeriu, kur ndodhet në raste të tilla, nuk di ç'bën. Po unë u përbajta. Dhe bëra mirë që u vërbajta, se, po t'i kisha rënë, kishte rrezik ta prishja më keq punën. Njerëzit filluan të dyshojnë për mua. Që në çastin e parë vura re se disa më shikonin me ngulm e si me dyshim. «Ç'kanë këta me mua? — thosha me vete. — «Pse më shikojnë ndryshe nga herët e tjera?» Pas pak i mora vesh të gjitha. Shokët e brigatës më thanë se ai tekniku, që ishte miku më i ngushtë i Petritit, qe futur në tunel menjëherë pas shembjes, kishte kontrolluar vendin, ku kishte ndodhur katastrofa dhe kishte mbajtur një procesverbal.

Për mua çdo gjë ishte e qartë. Ai atë çast priste. Ma merr mendja që edhe letrën, edhe lapsin për të mbajtur procesverbalin miku i Petritit e kishte gati në xhep. Nga sa më thanë shokët, ai, bashkë me një normist, qëndroi fare pak në tunel. Afërmenç që ata çdo gjë e kishin të pregatitur. Dhe hartuan shpejt e shpejt dokumentin. Sipas atij procesverbali, përgjegjësia për shembjen më binte mua. E kishte ngritur shumë mirë kurthim. «Faji kryesor për shembjen rëndon mbi brigadierin e brigadës së karpentierëve të turnit të dytë», thuhet në procesverbal. «Ai, në kundërshtim me rregullat teknike, përdori materiale të dobëta, që nuk lejohen kurrsesi në armaturat e tuneleve. Qëndrimi i brigadierit bëhet edhe më i dyshimitë po të mendohet se, disa orë para se të ndodhët shembja, ai u largua nga sektori i punës, duke e lënë brigadën vetëm... Largimin e tij në orën shtatë të mëngjetit e vërteton edhe zjarrmëtari Kolë Deda, i cili në atë orë ndodhej te gryka e tunelit dhe e pa çdo gjë me sytë e tij...»

Shikoni, pra, ku arrin djallëzia? Ai e kish kurdisur aq bukur punën, sa që e besuan shumë njerëz; bile edhe disa të njojur e miq të mi filluan të dyshonin për mua. Gjendja qe mjaft e rëndë. Çdo gjë tregonte se këtë përleshje të heshtur, po të ashpër, midis meje dhe gjometër Petritit, do ta fitonte ai. Këtë gjë unë e ndjeja nga qëndrimi i miqve dhe i shokëve, të cilët më shikonin të habitur, sikur donin të thoshin: «C'janë këto që dëgjojmë për ty, bre Mark?

Në fillim u hutova dhe s'dija si të veproja. Po e mora shpejt veten. «Sido që të bëhet, — thosha, — e vërteta do të dalë në shesh. Se nuk është

ajo kohë kur zotërinjtë mund të rrjihnin një djalë të vogël vetëm e vetëm sepse kishte pasur guxim të këndonte me zë të lartë një këngë partizane. Vetëm një gjë më shqetësonte shumë: qëndrimi i Kolës. Siç ju thashë emri i tij përmendej në mënyrë të veçantë në procesverbal. Kjo tregonte se gjeometri kishte besim te ai. Unë sillja ndërmend ato takimet e shpeshta të gjeometrit me Kolën dhe thosha me vete: «Kjo punë ka kohë që zien; tani i doli tymi. Ai e ka rregulluar punën me Kolën, i cili me siguri, do të flasë kundër meje».

Miqtë e mi thanë se do të bisedonin me Kolën, sepse sqarimi i çështjes varej shumë prej tij. Fjala e tij do të rëndonte shumë, kur do të vihej puna në balancë. Dhe, pa humbur kohë, e gjetën Kolën dhe biseduan shtruar me të. Po nuk morën ndonjë përgjigje të saktë. Kola i dëgjoi me vëmëndje të madhe, pastaj, duke buzëqeshur me dy kuptime, u tha: «Mos u ngutni, or miq. Do të vijë çasti që të flas edhe unë. Dhe do të flas gjérë e gjatë këtë radhë».

Kur të bëhet mbledhja e kolektivit, do t'i them të gjitha ato që kam dëgjuar e kam parë».

Këto fjalë të Kolës ishin si një thikë me dy presa. Domethënë çështja mbetej ende e errët dhe do të sqarohej në mbledhjen e kolektivit të kantierit.

Komisioni që ishte krijuar për të shqyrtauar shkaqet e shembjes filloi menjëherë nga puna. Dhe, siç qe e natyrshme, mua më thirrën nga të parët. Në komision bënte pjesë kryeinshinjeri i ndërmarrjes, tekniku që kishte bërë procesverbalin në vendin e shembjes dhe Bolsheviku. Siç ju thashë edhe më parë, tekniku ishte mik i ngushtë i gjeometër Petritit dhe, si doli më vonë, dora e tij e djathtë në të gjitha djallëzitë dhe poshtërsitë që kishte kurdisur.

Unë kur hyra në zyrën e kryeinxhinjerit, ku ishte mbledhur komisioni, e ndjeja veten mjaft të shqetësuar. Nuk është shaka të të ngrenë një kurth të tillë, të pregatitur me zell të madh prej kohe. Pastaj më shqetëson fakti se procesverbalin mbi shembjen e kishte përpiluar tekniku, që bënte lojën e gjeometër Petritit. Dhe tani tekniku ishte anëtar i komisionit. A nuk tregonte kjo se ai gjëzonte besimin e plotë të drejtorisë së ndërmarrjes?

Po kur hyra brënda në zyrë dhe pas hë ftyrën e qetë të «bolshevikut», e mora veten menjëherë dhe zura një vend në fund të tavolinës. I pari filloi kryeinxhinjeri. Ai më pyeti shumë gjëra lidhur me shëmbjen. Tekniku ndërhynte herë pas here me disa pyetje dinake për të më ngatërruar. Bolsheviku në fillim nuk fliste fare. Ai dëgjonte me vëmendje dhe herë-herë mbante ndonjë shënim në një blok të vogël.

Tani të na thuash përse u largove nga vendi i punës, nga tuneli — më pyeti në një çast kryeinxhinjeri.

— Përse e braktise punën të themi më mirë — ndërhyri tekniku.

Unë u preka menjëherë dhe u skuqa në ftyrë nga zemërimi.

— Mos u ngutni të nxirri përfundimet — e ndërpree aty për aty Bolsheviku.

— Për mua çdo gjë është e qartë — ja bëri tekniku. — Marku iku nga tuneli pikërisht atëhere kur, si brigadier duhet të ishte në krye të punës.

— Unë ju thashë edhe më parë — u përgjegjja unë. — Më lajmëruan të viaj këtu në drejtori, prandaj u largova.

— Po kush ishte ai? — pyeti përsëri kryeinxhinjeri.

- Nuk ja di emrin.
- Pse i besove një njeriu të panjohur?
- Bëra gabim. Thashë me vete se do të ishte ndonjë nëpunës i ri.
- Po fytyrën e tij nuk e mban mend?
- Megjithëse ishim brenda në tunel, po ta shoh përsëri, edhe mund ta njoh.
- Mua më duket si përrallë kjo — tha me qësëndi tekniku. — Se emrin nuk ja di, fytyrën edhe e mban edhe s'e mban mend... Atëhere mos ishte ndonjë fantazmë!
- Bën vaki që të ketë edhe fantazma në këtë mes — tha me kuptim Bolsheviku.
- Për një hop ra qetësi në zyrën e vogël. Dëgjohej vetëm zhurma e një kamioni që i ngjitej së përpjetës drejt tunelit.
- Dëgjo këtu — e mori pas pak fjalën kryeinxhinjeri. — Dil nëpër sektorët e ndryshëm të kantierit, gjeje atë që të lajmëroi të vije këtu dhe eja të na thuash: «Ja, ky është». Përndryshe e këpisk punën, se ne kemi menduar që, për këtë çështje, do të mbledhim sonte krejt kolektivin që të dalë e vërteta në shesh...
- Shumë mirë do të bëni — u përgjegja unë.
- Atje duhet të thuash të vërtetën.
- Edhe tani të vërtetën them.
- Atje do të flasin edhe të tjerë e jo vetëm ti
- e mori fjalën tekniku. — Prandaj vëri gishtin kokës...
- Kjo s'do të thotë gjë — tha qetë qetë Bolsheviku. Tek e fundit punëtori ka besim te shokët e tij punëtorë.
- Me kaq unë dola nga zyra për të kërkuar të panjohurin. Por ai ishte zhdukur pa lënë nishan.

Kur u ktheva përsëri në zyrë, kryeinxhinjeri bisedonte në telefon. Tekniku kishte dalë, kurse Bolsheviku shkonte poshtë e lart nëpër zyrë.

— E, e gjete? — më pyeti kur më pa te dera.

— Jo, — i thashë.

— Hë! — bëri i menduar. — Diçka fshihet në këtë mes.

— Kështu them edhe unë.

— Ti je i pastër? — më pyeti duke m'u afruar më shumë.

— Si uji i burimit të madh, që do t'ja çojmë Tiranës — ju përgjegja unë menjëherë.

— Atëhere mos ki merak.

— Dyshoj te Kola — i thashë me zë të ulët.

— Ti e di atë histori të vjetër...

Bolsheviku më shikoi një herë i menduar. Pastaj më zuri nga krahu e më tha me bindje:

— Edhe Kola punëtor është. E ma merr mëndja se do të thotë të vërtetën. Pastaj do të përpigem edhe unë ta takoj e të bisedoj me të....

Kur dola nga zyra e kryeinxhinjerit të gjithë ata që kishin mbaruar turnin e punës, e dinin që në mbrëmje do të bëhej mbledhja e kolektivit të kantierit, ku do të shtrohej çështja e shembjes. Gjeometër Petriti dhe miqtë e tij futeshin në mes të njerëzve dhe bisedonin me zë të ulët me njerëz të veçantë. Atëhere e kuptova më mirë se përleshjet me armikun s'kishin marrë fund. Një përleshje e tillë e ashpër dhe gjoks më gjoks do të zhvillohej atë natë atje, në njërin nga kantierët për ndërtimin e hidrocentralit «Lenin».

VII. E PAPRITURA

Mbledhja u bë në mbrëmje në një barakë që gjendej në qendër të kantierit. Ajo ishte një barakë e madhe prej dërrasash, e veshur nga brenda me karton dhe e mbuluar me letër katramë. Ajo barakë e madhe, sipas nevojave të kantierit, përdorej edhe si mensë, edhe si sallë mbledhjesh, edhe si kinema. Nga dritarja e kuzhinës nuk dilnin vetëm pjatat me gjellë, por edhe drita të forta të aparatit kinematografik. Kur bëheshin mbledhje, nga dritarja dukej koka e kuzhinierit të trashë e bullafiq, që ndiqte me vëmendje fjalët dhe bisedat e punëtorëve.

Gjatë ditës bënte zagushi, sikur të ishte pranverë, kurse në mbrëmje koha befas u prish dhe filloj një shi vjeshte, që trokëllinte me forcë në çatinë e ulët të barakës. Vetëtimat të verbonin për një çast dhe bubullimat të shurdhonin veshët, sikur të binin aty pranë, në sheshin e kantierit. Edhe brenda në barakë kishte shpërthyer një stuhim e madhe...

Mbledhja e kolektivit filloj me vonesë, sepse priteshin edhe punëtorët që punonin për pastrimin e dbeut në vendin e shembjes. Nga sa flitej, në atë mbledhje do të merrte pjesë vetë drejtori i ndërmarrjes dhe një i deleguar nga Ministria e ndërtimit. Do të mjaftonte vetëm kjo për të kuptuar se puna qe trashur shumë dhe do të merreshin masa rrepta. Po kundër kujt? Po t'i besohej procesverbalit, masat duhej të merreshin kundër meje. Mirëpo dardha e ka bishtin prapa, i thonë një fjale. Në mbledhje do të shihej se ç'do të thoshin edhe të tjerët. Dhe sidomos Kola...

Në barakën e madhe të mensës ishin grumbulluar mjaft punëtorë shumë kohë përpara se të filloonte mbledhja. Moti qe ftohur përnjëherësh, prandaj qe ndezur edhe zjarri. Në mes të barakës ishte vendosur një fuçi boshe, që përdorej si sobë. Një grup punëtorësh kishin zënë vend rrëth sobës dhe bisedonin për ngjarjen e ditës, për shembjen që kishte ndodhur në tunel. Kishte nga ata që thoshin se nëpër tunel ndodhnin shpesh shembje dhe më kot kërkonin të bënин njeri me faj. Të tjerë shfaqnin mendimin se shembja e kishte një shkak. Ndaj duhej të gjendej edhe shkaktari.

— E drejtë, — ndërhyri e tha me bindje të plotë minatori. — Nëpër galeritë e minierave e nëpër tunele bën vaki që të ndodhin shembje, po asnjëherë pa shkak.

— Kështu është, — pohoi plot gojën edhe Marku. — Edhe për rastin tonë puna ishte e qartë se shembja s'kishte ndodhur pa shkak. Puna ishte si do të gjendej shkaktari i vërtetë. Me përjashtim të atyre që kishin firmosur procesverbalin e që ma ngarkonin mua fajin, asnjë tjetër nuk mund të thoshte me siguri këtë gjë. Një pjesë e mirë e punëtorëve nuk u besonin fjalëve që kishin përhapur miqtë e gjeometrit se gjoja unë isha fajtor për shembjen që kish ndodhur.

Unë kisha zenë vend pranë drifteve dhe, nën driften e vetëtimave të shpeshta, shikoja shiun që binte pareshtur.

Në thellësi të shpirtit ndjeja një siguri të një bindje të patundur se shpejt ose vonë e vërteta do të dilte në pah. Fjalët e Bolshevikut ma kishin ngrohur shumë zemrën. Po gjendja atë ditë ishte ngatërruar aq shumë, sa që s'ishte e mundur të

mos ndjeje shqetësim e tronditje. Herë-herë më vinin në vesh fjalët e punëtorëve, që ishin grumbulluar rrëth sobës së madhe dhe bisedonin me gjallëri. Biseda bëhej, sigurisht për punën e shembjes. Kjo tregonte se gjithë kantieri merrej me këtë problem.

— Është e vërtetë se komisioni ja ka ngarkuar fajin Markut? — pyeti një zë i hollë, si prej të riu.

— Jo komisioni, por ata që kanë përpiluar procesverbalin në vëndin e shembjes.

— Pse e pakët është kjo?

— Ata të procesverbalit Markut ja kanë ngarkuar fajin:

— Po pse Markut?

— Sepse ai ka përdorur materiale të dobëta, që nuk lejohen kursesi në armaturë.

— Po Marku s'është axhami, or vëlla.

— Këtu është meseleja...

— Axhami nuk është, po, nga sa thonë, ai iku nga tuneli dhe erdhi këtu në kantjer.

— Pse iku? — pyeti një tjetër.

— Thonë se e kish lajmëruar një njeri të vinte me ngutje këtu, po nuk gjendet se kush është.

— Ne njihemë të gjithë këtu në kantier!

— Epo ja, këtu është nyja. Kjo më vë edhe mua në dyshim: Si i dha besë Marku një të panjohuri dhe braktisi vendin e punës?

— Kanë dëshmitarë për këtë gjë?

— Posi, kanë Kolën. Kola i ka parë të gjitha këto me sytë e tij. Kështu thonë. Të shohim tanë se ç'do të na thotë Kola në mbledhje.

— Daleni, bre burra, — u dëgjuar një zë i fortë dhe i qetë. — Po Kola sikur nuk i ka mirë

punët me Markun. Ata diçka kanë midis tyre dhe nuk flasin kurrë me njeri-tjetrin.

— Po, kanë pasur një hasmëri të vjetër, — u përgjegj zëri prej basi.

— Pse, e vogël është kjo? Në e mban ende në zemër urrejtjen kundër Markut, mund ta marrë në qafë. Apo nuk kanë ndodhur gjëra të tilla!

— Ndaj themi edhe ne se kjo çështje është shumë e ngatërruar. . .

«Po, shumë e ngatërruar, — thashë edhe unë me vete dhe u mblodha kruspull pranë drifores. — Njerëzit, para se të vendosin, do të presin të dëgjojnë fjalën e Kolës. Në qoftë se gjeometër Petriti e ka futur atë në thes dhe ai flet kundër meje, më mori lumi. S'do mend që do të flas edhe unë. Dhe do t'u flas me dorë në zemër shokëve. Pas meje do të flasin edhe shumë të tjera. Po anën e kujt do të marrin? «Këtu është puna».

Sikur të donte të më jepte një përgjigje për ato dyshime që më torturonin shpirtin, zëri i hollë tha:

— Unë, or shokë, në rast se Kola do të përpinqet t'ja ngarkojë fajin Markut, do të ngrihem e do të them: «Shokë! A e dini ju se Kola ka hasmëri me Markun dhe e urren? . . .».

— Pusho, mor djalë, — ju përgjegj ai zëri prej basi. — Kjo punë nuk është aq e thjeshtë, sa thua ti. Nuk është puna e hasmërisë në këtë mes. Pse u përdorën dërrasa e trarë të hollë nga brigada e Markut? Pse u largua Marku tamam në atë çast që duhej të ishte atje, në tunel? Ohu, është shumë e ngatërruar kjo punë. . .

Zëri i hollë nuk u përgjegj më. Në vend të tij dikush tjetër tha:

— Ka diçka në mes. Në fillim edhe unë nuk u besova fjalëve që u përhapën për përgjegjësinë e Markut, po, kur më thanë se braktisi brigadën dhe vajti kotsékoti në kantier, thashë me vete: «Ka një dorë të ligë këtu... Pastaj nuk ka ardhur kot këtu drejtori i ndërmarrjes me dy tre veta të tjerë. Ata kanë krijuar edhe një komision, që ka filluar hetimet që në mëngjez, dhe si duket ende nuk e kanë gjetur mirë fillin e kësaj çështjeje.

Biseda u ndërpre në mes. Dera e mensës u hap me vrull dhe i pari u duk drejtori i kantierit. Pas tij vinte i deleguari i ministrisë, drejtori i ndërmarrjes, Bolsheviku dhe disa njerëz të tjerë, që nuk i njihja. Pas tyre hyri me hapa të shpejta gjometër Petriti. Bile m'u duk sikur ju afroa dhe i tha diçka në vesh drejtorit të ndërmarrjes, duke treguar nga ana ime. Sa i egër dhe i lig m'u duk në atë çast! Nuk ndryshonte fare nga ajo ditë e largët, kur më kishte zhëpur në dru, sepse kisha patur guxim të këndoja një këngë partizane atje, majë shkëmbit... Po ajo që më tronditi shumë, ishte diçka tjetër. M'u duk sikur edhe drejtori i kantierit më shikonte vetëm mua. Edhe të tjerët, megjithëse nuk më njihnin, sikur nuk i ndanin sytë nga unë. Ndoshta nuk ishte ashtu, por mua ashtu m'u duk dhe ula kokën si turpëruar. Po shpejt e ngrita përsëri duke thënë me vete:

«Pse të turpërohem? Pse të kem frikë? Unë jam i pafajshëm. Dhe e drejta shpejt ose vonë, do të fitojë. Nuk është më ajo kohë kur punëtorët dhe varfanjakët merreshin nëpër këmbë!»

Në atë çast u ngrit e foli drejtori i kantierit. Unë isha mjaft i tronditur dhe nuk e mbaj mend mirë se ç'tha. Po më kujtohen pak a shumë këto

fjalë: «Kemi për të shtruar një çështje me shumë rëndësi. Sot në mëngjez na u shemb papritur tuneli. Dhe nga shembja na u shkaktua një dëm i madh. Dheu që ra na bllokoi hyrjen dhe punimet në ballë të tunelit u ndërprenë. Dheu u nxuar shpejt e shpejt jashtë, armatura e prishur u ndreq menjëherë dhe tani luanët e maleve janë duke vazhduar luftën për të çarë shkëmbin. Por nuk është vetëm kjo. Nga shembja na u plagosën tre punëtorë. Prandaj çështja është shumë serioze. Pa mendoni sikur ata të kishin vdekur!...»

«Oh! — ja bëra unë padashur dhe më theri në zemër. Drejtori tha edhe shumë fjalë të tjera dhe në fund lexoi procesverbalin, që ishte mbajtur nga miku i gjeometër Petritit në vendin e shembjes. Ky ka qenë çasti më i vështirë i jetës sime. S'mbaj mend kurrë në jetën time të jem gjetur më ngushtë. Jo nga fjalët që thuheshin në atë copë letër, jo. Po nga vështrimet e shokëve. Të gjithë punëtorët kthyen sytë nga unë, sikur të isha me të vërtetë fajtor. Shikimet e tyre sikur donin të më thoshin: «Ti, o Mark, e bëre këtë hata?! Vërtet? Pse ul kokën? Mos përpinqesh të fshihesh? Nuk do t'ja arrish dot. Kuvendi ynë është gjithnjë i drejtë, po edhe i rreptë. Prandaj ngreu e folë. Këtu, në sheshin e burrave».

Dhe unë u ngrita. Fola mjaft. Po nuk ua mbusha dot mendjen shokëve. Këtë e ndjeja fare mirë dhe mund të thuash se e lexoja në sytë e tyre. Para se të ulesha përsëritura edhe një herë: «Unë jam i pafajshëm», po e pashtë se shumë punëtorë tundnin kokën si me dyshim. Kur mbarova, në sallë u dëgjuan pëshpëritje.

— Kush do të flasë tjeter? — u dëgjua zëri i fortë i drejtorit.

— Të flasë Kola! Kola, — thirri me të madhe ai, tekniku, që siç ju thashë, mbante anën e gjeometër Petritit.

— Po, Kola! — e pasuan disa zëra të tjerë.

Unë u ula në vendin tim dhe shtrëngova ballin me dorë. Për një çast në sallë sundoi një heshtje e thellë. Të gjithë prisnin të fliste Kola. Ai kishte hyrë në mensë i fundit, bashkë me një grup punëtorësh që kishin punuar për pastrimin e tunelit.

— Mirë, or shokë, do të flas edhe unë, — ja nisi Kola me një zë të trashë dhe pak si të ngjirur. Gjithë ata që gjendeshin në sallë, prisnin të dëgjonin me padurim se ç'do të thoshte Kola. Kjo dukej nga shikimi e nga shprehja e fytyrës së tyre. Kola qëndroi një çast. Në sallë s'pipëtinte asgjë. Dëgjoheshin vetëm pikat e shiut mbi çatinë e barakës.

— E që thoni ju, or shokë, — vazhdoi pas pak Kola, sikur bisedonte me anëtarët e brigadës, — unë do të flas pak gjatë sot. Dhe kam përsë të flas. Për disa gjëra që ndodhin këtu, te ne, nën rrogoz, unë duhej të kisha folur prej kohe. Po, nejse... Që kur se kam ardhur në kantier, shikoja punën time dhe nuk thosha asgjë; se e kam zët të folurit andej këndejej, ashtu siç bëjnë disa. Tani e kuuptoj se kam bërë gabim që s'kam folur. Po ç'të bësh? Mendja e njeriut i ngjan një dite që gdhihet si me avuj e me mjegull dhe kthjellohet pak nga pak nga dielli. Kështu më duket mua. Nuk di si thoni ju, shokë.

— Vazhdo, Kolë! — i thirri dikush.

— Doemos që do të vazhdoj, sepse sot do të flas edhe për herët e tjera që kam heshtur.

«Ama ç'të kurdisur që i kanë bërë! — thosha unë me vete duke pritur me ankth. — Kola që zakonisht nuk e hapte kurrë gojën në mbledhjet e sektorit dhe që përgjigjej vetëm kur e pyesnin për ndonjë gjë, tani na e nis me gjithë këtë hyrje, si ndonjë gojtar i stërvitur». Kanë kaluar qysh atëherë afro shtatëmbëdhjetë vjet, po aq përshtypje më ka bërë ai diskutimi i Kolës, sa që e mbaj mend edhe tani, thuajse, fjalë për fjalë. Do të thosha bile, se më kujtohen mirë edhe lëvizjet e duarve, edhe shprehja e fytyrës, edhe zëri i tij, që ngrihej valë-valë.

— Tani, — vazhdoi Kola, — ju kërkoni nga unë që të flas për shembjen që ndodhi sot në mëngjerez në tunelin kryesor. Bile emri im përmëndet edhe në procesverbalin, që është mbajtur në vend, ndonjë gjysmë ore pasi kishte ndodhur e keqja, dhe që u lexua edhe këtu. Mirë, pra. Do të flas. Po, para se të flas për atë të sotmen, do të them edhe diçka tjeter. Ju e dini se te ne kanë ndodhur edhe shembje të tjera. Sigurisht jo aq të mëdha si kjo e sotmja. Sidoqoftë, edhe ato kanë qenë shembje. Po herët e tjera s'kemi mbajtur as proces-verbal, s'kemi bërë as hetime, as mbledhje si kjo e sotmja. Pse do të thoni ju? Sepse ata që i shikonin në vend shembjet e mëparshme, na thoshin: Kjo shembje ka ndodhur për shkak të ujit që ka rrjedhur nga barku i malit; tjetra ka ndodhur mëqë toka qe e shkrifët. Një herë tjeter — e mbanimend, or shokë? — ngriti zérin Kola — njëherë tjeter, pra, na thanë se fajin e kishte pasur gjoja tërmeti që kishte rënë atë ditë s'mbaj mend as unë në ç'vend të Shqipërisë. Po unë them se në të gjitha këto raste ka pasur gisht një njeri, që rron midis nesh dhe tani gjendet në këtë mensë.

Një zhurmë e lehtë u përhap në gjithë sallën. U dëgjuan pëshpëritje, kërcitje stolash. Disa kthyen kokën nga ana ime. Të tjerët shikoheshin midis tyre me habi, sikur donin të pyesnin njëri tjetrin: «Kush do të jetë ky?» Dhe në atë çast shumë grushta u shtrënguan në heshtje.

Kola qëndroi për pak si i menduar. Hodhi një shikim në gjithë sallën, pa vështrimet e shumë njerëzve që ishin drejtuar nga ai, dhe vazhdoi.

— Po, bre burra. Ka gisht njeriu në këtë mes. Atëhere as unë nuk e dija se ç'ndodhë me të vërtetë. Po shembja e fundit bëri që ta shikoj mirë atë gisht tinzar... E di se prisni me padurim që të merrni vesh se kush është ai. Unë ato që di, do t'i them. Të tjerat i plotësoni ju.

— Folë, Kolë! Me guxim! Ashtu si e ke nisur!
— u dëgjua një zë i fortë nga mesi i sallës.

— Po, për sytë e ballit, do të flas troç; me dorë në zemër, or shokë. Se tani që jam midis jush, më duket sikur jam pranë vatrës dhe kuvendoj me njerëzit e mi. E që thoni ju, or shokë, merimanga që punon prej kohe këtu, te ne, e ka endur mirë e bukur pëlhirën, sa që nuk të shkon mendja kurrrë. Dhe mendonte se më kishte zënë edhe mua në rrjetën e saj. Po punëtorët nuk bien lehtë në kësi kurthesh... Apo jo, or shokë?!

Kureshtja e dëgjonjësve shtohej gjithnjë e më shumë. Disa shkundnin me bërryl atë që kishin pranë duke pyetur: «More, ç'hotë? Për cilin e ka fjalën?» Edhe ata të presidiumit shikoheshin midis tyre si të habitur. «Bolsheviku» rrinte i qetë, gjak-ftohtë. Herë hërë hidhte vështrimin nga ana ime e sikur më buzëqeshte lehtë.

— Në procesverbal, — vazhdoi Kola, — thuhet.

se fajtor për shembjen e sotme është Marku, «sepse, — thuhet atje, — përdori materiale të papërshqatshme në armaturë dhe pastaj e braktisi brigadën e iku». Po pse iku? Këtu është sekreti. Ai iku, sepse e thirri një njeri. Marku bëri gabim që iku, po këtë gabim mund ta bënte çdo njeri nga ne. Sepse ai njeri i tha se e kërkonin me ngutje në drejtori. Dhe Marku doli me vrap. Unë isha te gryka e tunelit dhe e pashë. Po as mua nuk më shkonte mendja për keq në atë çast. Kur ndodhi shembja m'u hapën sytë menjëherë. Dhe i kuptova të gjitha. Dyshimet e mia u forcuan. Dhe vrapova menjëherë ta kapja atë njeri të dyshimit. Nuk e kapa dot, se ai u zhduk në pyll. Po s'ka gajle; do kapat ndonjë ditë edhe ai. Bashkëpunëtorët e tij këtu i ka lënë. Nejse.... Tani është puna për Markun. Unë ju them, bre burra, se Marku nuk është fajtor dhe nuk ka hiç gisht në këtë shembje. Ata që kanë sajuar procesverbalin, gënjejnë. Po, besa, gënjejnë pa turp!

Një «Ah» lehtësonjës doli nga kraharori i shumë dëgjonjësve. Unë e humba për një çast. M'u duk sikur shikoja një èndërr të bukur dhe nuk desha t'u besoja fjalëve që më vinin në vesh. Nga sa më thanë shokët më vonë, ftyra e asaj «merimange» siç e quajti Kola, ndërronte njëmijë ngjyra në sekondë.

— Në procesverbal përmendet edhe emri im, — vazhdoi Kola. — Po unë s'mund të gënjej. E pse të gënjej? Që të mbulohet ajo dorë kriminele, që bëri të na plagosen tre shokë? Ata që i kurdisen këto, ashtu mendonin. Që unë do të flisja kundër Markut e do t'i vija kapak kësaj çështjeje. Domenthenë ta merrja në qafë Markun. Ç'e kam unë

Markun? Është e vërtetë se familjet tona kanë pasur hasmëri midis tyre. Këtë besoj se e dini edhe ju. Në mos të gjithë, një pjesë e mirë e kanë dëgjuar. Po, or shokë, kemi pasur hasmëri. Po t'ju them tani se unë nuk ndjeja urrejtje kundër familjes së Markut, do të gënjeja. Bile edhe për Markun ndjeja diçka këtu në zemër, si t'ju them: si mëri, si zemërim; bile ngandonjëherë më shkonte mendja edhe në ligësi. Në fillim natyrisht. Po, or Mark po! — ngriti zërin Kola, duke shikuar nga unë. — Kjo më ndodhi para disa vjetësh, kur erdha nga qyteti në fshat. Edhe në javët e muajt e parë këtu, në kantier, unë të vështroja me bishtin e syrit. E vërteta është se ti ngandonjëherë më vështroje si i habitur, sikur deshe të më thoshet: «Hala te ura ti, o Kolë? Do të vazhdojmë të mbajmë hasmërinë e vjetër? Dhe nuk do të flasim midis nesh? Nuk do t'i themi as mirëmëngjez njëri tjetrit?» Unë ktheja kokën nga ana tjetër dhe s'të flisja. Nga se thua ti? Nga kryeneçësia? Po, or burra, po, — tha duke ju drejtar të gjithëve. — Ju i keni parë vetë të gjitha. Po i ka parë sigurisht edhe merimanga, që endte pëlhirën rrëth nesh. Ai donte të qëronte hesapet me Markun. Këtu ishte puna...

Gjithë salsa lëvriu. Në rreshtat e para u dëgjuua një zhurmë e mytur. Gjeometër Petritit i kishte rënë të fikët. Disa thoshin se i kishte pushuar zemra. Të gjithë u mblodhën atje. Nuk e di sepse nuk lëviza nga vendi. Me mendjen time thosha: Të mos vdesë; të rrojë që ta kuptojë mirë se koha e tij ka marrë fund. Tani ka ardhur koha e punëtorëve. Tjetër gjë nuk mbaj mend. Atë e suallën shpejt në vete. Pastaj folën edhe të tjerët. Foli përsëri

drejtori i kantierit dhe në fund e mori fjalën drejtori i ndërmarrjes. Por, po të më pyesni se ç'thanë, s'jam në gjendje, që t'ju përgjigjem. Vëtëm një gjë më kujtohet mirë: Pas Kolës folën edhe shumë punëtorë të tjerë. Aty nga fundi foli edhe Bolsheviku. Një heshtje e thellë ra në sallë kur e mori fjalën ai. Unë, megjithëse kisha qenë si i dehur nga gëzimi, e dëgjova me vëmendje dhe më kanë mbetur gjer tanë në mendje fjalët që tha ai atë ditë: «Nuk është për t'u çuditur, shokë, për atë që bëri ky armik i fshehur — e nisi ai duke treguar nga ana e gjeometër Petritit. — Armiku pëlqet kur shikon këto vepra që ndërtojmë ne dhe bën ç'mos që të na pengojë. A i keni parë ju ata gjëmbaqë që rriten nëpër ledhet e arrave e nëpër djerrinat? Ata nuk të çjerrin lëkurën vetëm në behar, kur kanë kohën e tyre të rritjes, por edhe në dimër, kur bien përtokë, meqë u ka kaluar vakti. Ti kalon rrugës dhe i shikon si të fishkura e të thara. Mirëpo po të mos kesh mendjen, të gjervishin që ç'ke me të. Ndaj ne, duhet t'i shkelim mirë me këmbë, gjersa t'i bëjmë baltë...» Kur mbaroi mbledhja, as unë nuk e di se si u gjenda në mes të një grupei shokësh. Pranë meje qëndronte Kola. Po, Kola! Ai më kishte hedhur dorën në krah dhe unë i shtrëngojë dorën. Të gjithë ishin të gjuar dhe të entusiazmuar, po më shumë nga të gjithë, unë me Kolën. Na dukesh sikur kishim korrur një fitore të madhe në një përleshje të ashpër kundër një armiku mizor.

— Po gjeometri ç'u bë? — pyeti me padurim Maqua.

— Gjeometri vajti atje ku duhej. Vajti për t'u takuar me vjehrën, me ish të zotin e kësaj vile

këtu. Nuk jam interesuar të merrja vesh hollësira rrëth familjes së tij, po kisha dëgjuar se vjehri i tij që burgosur që në vitin e parë të çlirimit. Ndërsa i ati i kishte vdekur nga marazi ato ditë kur doli në gazetë ligja mbi reformën agrare.

— Tani ende në burg është gjeometri?

— **Nuk** e di. Nuk kam pyetur. E kam parë edhe njëherë tjetër, mbas asaj mbledhjeje që ju kallëzova, në sallën e gjyqit. Unë dhe Kola ishim dëshmitarë. Sa gjëra të tjera i dualën atë ditë në gjyq! Duke dalë nga gjyqi i thashë Kolës: «Tani e kuptova më mirë se sa të liq e të poshtër janë armiqtë tanë...»

Marku u ndal dhe menjëherë u ngrit në këmbë. Kjo tregonte se kallzimi kishte marrë fund.

— Ke të drejtë, o Mark! — tha me zë të ulët e të qartë minatori. — E di si them unë me mendjen time? Ne jemi njerëz të punës. Secili nga ne përditë do të bëjë diçka të vlefshme. Do të ngrëjë, të themi, një ose dy metra mur; do të ndreqë një maqinë të prishur; do të shtypë një libër; apo do të nxjerrë nga galeria disa tonelata mineral. Ndaj edhe mendojmë gjithnjë për të mirën. Po të marrësh armiqtë, ata e kanë mendjen si të prishin e të shkatërrojnë. Kështu them unë.

— Dhe kështu është — tha me plot gojë Ademi.

Marku doli në ballkon për të soditur detin. Qielli ishte ende i vrërët, po dallgët e detit sikur ishin fashitur. Koha po përmirësohej. Pas tij dolën edhe të tjerë në ballkon.

Të nesërmen historinë e Markut e kishin marrë vesh dhe shumë punëtorë të tjerë. Jo drejtpërsëdrejti nga Marku, po nga goja e minatorit, e Maqos, e Ademit dhe e vajzave. Pas disa ditësh këtë histori

e kishin dëgjuar, gjer në hollësirat më të vogla, të gjithë kampistët.

Ditët e pushimit mbaruan dhe secili u nis për një vendin e punës. Ata muarën me vete, bashkë me përshtypjet e tjera nga kampi, edhe ndodhinë interesante të Markut. Dhe atë histori e përhapën nëpër kantiere, fabrika, uzina dhe miniera. Nga një kantier ndërtimi të një qyteti të ri u muar kjo histori dhe u bë një libër i vogël, që ta marrin vesh gjithë fëmijët e Shqipërisë. —